



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

INSPEKTORATI QENDROR

MESAZHI NGA INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Raporti i veprimtarisë së inspektimit për vitin 2015, të cilin po ju paraqesim, është një pasqyrë e veprimtarive të kryera nga i gjithë sistemi i inspektimit për arritjen e rezultateve të pritshme të reformës së inspektimit. Gjatë kësaj periudhe Inspektorati Qendror, Inspektoratet Shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese kanë zhvilluar veprimtari intensive në drejtim të avancimit të sistemit “e-Inspektimi”, si pjesë e rrjetit të qeverisjes elektronike. Sistemi “e-Inspektimi” pritet të krijojë hapësira për të rritur transparencën dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese, si dhe uljen e korrupsionit dhe përmirësimin e klimës të të bërit biznes në vendin tonë.

Nën udhëheqjen metodologjike të Inspektoratit Qendror, gjatë vitit 2015, Inspektoratet Shtetërore/ trupat e tjera inspektuese ndërmorrën veprimtaritë për standardizimin dhe përshtatjen e procedurës së tyre inspektuese me procesin e ri të inspektimit. Ato filluan të zbatojnë në praktikën e tyre të përditshme të inspektimit, procedurën, dokumentacionin dhe metodologjitë e reja të inspektimit. Inspektorati Qendror udhëhoqi ata në ndryshimet ligjore, metodologjike, si dhe trajnoi inspektorët shtetërorë për aplikimin e procedurës së re të inspektimit, me qëllim rritjen e efektivitetit për funksionet e inspektimit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Nën mbikëqyrjen e Inspektoratit Qendror, Inspektoratet Shtetërore/trupat e tjera inspektuese përmirësuan efektivitetin e punës së tyre dhe rritën performancën duke sjellë forcimin e rolit të tyre në parandalimin e rreziqeve dhe garantimin e zbatimit të rregullave të detyrueshme në veprimtarinë e subjekteve të inspektimit e konkurrencën e ndershme. Për pasojë u rrit forca ndëshkuese e tyre për rastet e mosrespektimit të rregullave të detyrueshme. Ndërkohë, është në proces krijimi Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, për t’i shërbyer më mirë rritjes së sigurisë publike.

Një arritje tjetër është edhe përmirësimi i frymës së bashkëpunimit ndërmjet Inspektorateve Shtetërore/ trupat e tjera inspektuese, që ishte edhe një nga risitë e reformës së inspektimit, për ta parë inspektimin, si një veprimtari shtetërore të unifikuar dhe jo të ndarë në fusha influence, por si një aktivitet ku ka vend edhe për inspektime të përbashkëta, bazuar në procedurë, dokumentim dhe teknologji të njëjtë për të gjithë sistemin e inspektimit.

Ne duhet të punojmë së bashku për ta kthyer sistemin e ri të inspektimit në histori suksesi për Qeverinë Shqiptare dhe për të garantuar sigurinë publike dhe cilësinë e jetës në vendin tonë.

PËRMBAJTJA

MESAZHI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

I. PËRMBLEDHJE

II. HYRJE

Qëllimi
Objektivat
Metodologjia

III. FINALIZIMI I REFORMËS NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT

VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT.

- 1) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- 2) Ministria e Shëndetësisë
- 3) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
- 4) Ministria e Mjedisit
- 5) Ministria e Punëve të Brendshme
- 6) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- 7) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
- 8) Ministria e Arsimit dhe Sportit
- 9) Ministria e Kulturës
- 10) Ministria e Energjisë dhe Industrisë

V. KOMENTE

VI. PRAKTIKAT E MIRA

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

VIII. KONKLUZIONE

IX. REKOMANDIME

X. ANEKSE

ANEKSI I: Lista e akteve nënligjore të miratuara gjatë vitit 2015 nga Inspektorati Qendror.

NEKSI II: Ligje Sektoriale të miratuara gjatë vitit 2015.

ANEKSI III: Draft aktet nënligjore për miratim.

I. PËRMBLEDHJE

Sistemi i inspektimeve tashmë në kuadër të reformimit ka pësuar ndryshime thelbësore, të cilat sollën një rritje të performancës së këtij sistemi. Modeli i ri i inspektimeve ka vendosur standarde të unifikuara organizative dhe procedurale të inspektimit, dokumentacion dhe teknologji të njëjtë të aplikuar për të gjithë Inspektoratet Shtetërore. Procesi i inspektimeve është orientuar drejt inspektimit elektronik, me pritshmëri rritjen e efektivitetit, transparencës dhe koordinimit të inspektimit.

Për gjatë këtij viti, ka përfunduar procesi i riorganizimit për 6 Inspektorate Shtetërore, si dhe është në proces riorganizimi Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, i cili pritet të fillojë punë gjatë periudhës në vazhdim.

Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore pilot po bën të mundur përdorimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, i cili ka filluar të operojë duke dhënë mundësinë që një pjesë e konsiderueshme e inspektimeve të kryhen nëpërmjet tij, duke kryer inspektime dhe regjistrime të procedurës në kohë reale nga terreni.

Nga inspektoratet e përzgjedhura pilot, vetëm nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë ka kryer rreth 916 inspektime online duke shkurtuar afatet kohore të qëndrimit të inspektorëve shtetërorë pranë subjektit të inspektimit, si dhe minimizimin e veprimeve abuzive gjatë procesit të inspektimit.

Ndërsa, Inspektorati Shtetëror të Shëndetësisë, Inspektorati Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit nuk janë akoma përdorues të portalit unik të inspektimeve.

Gjithashtu, është punuar në përmbushjen e objektivit për komunikimin e Portalit unik “*e-Inspektimi*” me platformën qeveritare të ndërveprimit.

Synimi jonë është krijimi i një sistemi modern inspektimesh në formë, përmbajtje dhe teknologjinë mbështetëse, ku të përfshihen të gjithë inspektoratet shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të rritjes së efektivitetit dhe transparencës së punës së inspektorateve shtetërore është përditësuar Regjistri Kombëtar i inspektorëve shtetërorë në detyrë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror dhe në portalin “*e-Inspektimi*”.

Inspektorati Qendror ka pajisur rreth 1000 inspektorë shtetërorë me kartën e inspektorit, me të cilën identifikohen ata gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre inspektuese.

Synimi jonë është krijimi i një sistemi modern inspektimesh në formë, përmbajtje dhe teknologjinë mbështetëse, ku të përfshihen të gjithë inspektoratet shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Nga procesi i mbikëqyrjes ushtruar nga Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe “*e-Inspektimi*” pranë Inspektoratit Qendror ndaj Inspektorateve Shtetërore, përgjithësisht ka gjetur zbatim ligji për inspektimin.

Gjatë këtij viti, 6 Inspektorate Shtetërore kanë hartuar dokumentacionin standard të inspektimit

dhe kanë hartuar listëverifikimet përkatëse, ndërkohë që janë në proces dhe 3 inspektorate të tjera.

Gjithashtu, Inspektorati Qendror ka patur një rol të rëndësishëm në zbatimin me korrektësi të ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit.

Në zbatim të prioriteteve të Qeverisë në fushatën kundër informalitetit në ekonomi, gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2015, Inspektorati Qendror është përfshirë edhe në koordinimin e grupeve të përbashkëta të punës midis Inspektorateve Shtetërore dhe inspektorëve tatimorë duke vënë në dispozicion burimet njerëzore të 4 inspektorateve shtetërore¹, si dhe pajisjen me 457 paketa portabël (laptop, skaner, printer) për të mundësuar realizimin e kësaj fushate, e cila bëri të mundur:

1. Identifikimin e të gjithë subjekteve private që operojnë në Republikën e Shqipërisë;
2. Pikëzimi në hartë i subjekteve private nëpërmjet aplikacionit gjeohapsinor WEB GIS;
3. Popullimi i hartës me të gjithë informacionin e kërkuar nga ky aplikacion për çdo subjekt.

Krahas këtyre arritjeve nga ana e Inspektoratit Qendror është punuar për forcimin e mbikëqyrjes dhe koordinimit të veprimtarisë inspektuese, nëpërmjet ushtrimit të kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese në 8 Inspektorate Shtetërore²/ trupa inspektuese, nga 14 të tilla.

Inspektorati Qendror ka hartuar raporte mbikëqyrje për të gjitha inspektimet mbikëqyrëse të kryera, ku janë evidentuar disa mangësi dhe problematika në zbatimin e ligjit të inspektimit, si dhe të legjislacionit specifik, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese me qëllim rritjen e efektivitetit dhe unifikimin e veprimtarisë inspektuese në të gjithë sistemin e inspektimit.

Raporti i Përgjithshëm për inspektimet në Republikën e Shqipërisë për vitin 2015, përfshin veprimtarinë e Inspektoratit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore/trupa të tjera inspektuese, lidhur me praktikën e mira, konkluzionet, gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e performancës së Inspektorateve Shtetërore në të ardhmen.

Ky raport paraqet ecurinë e reformës me rezultate konkrete si: planifikimi i veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, unifikimin e procedurës së inspektimit nëpërmjet standardizimit të dokumenteve dhe listë-verifikimeve, trajnimeve për rritje të performancës së inspektorëve shtetërorë, metodologji inspektimi të unifikuar.

II. HYRJE

Ky Raport jep një përmbledhje të rezultateve të arritura gjatë reformimit të inspektimeve dhe të

¹ ISHPSHSH, AKU, ISHSH dhe ISHMP

² Inspektorati Shtetëror Shëndetësor,

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore,
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore,
Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet,
Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave,
Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

impaktit që ajo ka patur në sistemin e inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Raporti pas analizës së hollësishme të ndryshimeve të ndodhura në sistem do të udhëzojë finalizimin e reformës së sistemit të inspektimit në Shqipëri.

Qëllimi i Raportit

Raporti synon të japë një vlerësim objektiv për arritjet e procesit të inspektimeve në vendin tonë gjatë vitit 2015, një panoramë të plotë të aktivitetit të kryer nga Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për vitin 2015, analizë e veprimtarisë së Inspektorateve Shtetërore me gjetjet e konstatuara gjatë misioneve të mbikëqyrjes të Inspektoratit Qendror, si dhe rekomandimet e dhëna në raportet e mbikëqyrjes, me qëllim që të bëhen përmirësime në të ardhmen.

Raporti rrit transparencën ndaj subjekteve të inspektimit dhe publikut të gjerë, për arritjet e sistemit të inspektimit, aktivitetin e zhvilluar nga Inspektorati Qendror, Inspektoratet Shtetërore/trupa të tjera inspektuese dhe përmirësimit të performancës së tyre në të ardhmen.

Objektivat e Raportit

Hartimi i këtij raporti bëhet në përmbushje të detyrimeve ligjore që ka Inspektorati Qendror për aktivitetin e përvitshëm:

1. Të evidentojë veprimtarinë e vitit 2015 për të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat inspektuese që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Të japë me transparencë dhe objektivitet gjetjet e konstatuara nga Inspektorati Qendror gjatë mbikëqyrjes së aktivitetit të Inspektorateve Shtetërore, si dhe rekomandimet për përmirësimin e aktivitetit të tyre.
2. Të paraqes raportin për njohje Këshillit të Ministrave, sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.
3. Të njoftojë Inspektoratet Shtetërore për nevojën për të bërë ndryshimet e duhura dhe në kohë për të rritur performancën në inspektime, si dhe ndërgjegjësimin e publikut.
4. Të vendosë rregulla dhe standarde të përgjithshme të raportimit të Inspektorateve Shtetërore sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur është ajo e raportimit në mënyrë progresive të arritjeve në sistemin e inspektimit. Për këtë u bënë analiza dhe vlerësime të dokumenteve strategjike të inspektimit,

legjislacionit në fuqi për inspektimin, si dhe të gjetjeve në raportet e mbikëqyrjes së disa Inspektorateve Shtetërore të hartuara nga Inspektorati Qendror gjatë vitit 2015.

Gjithashtu, për hartimin e Raportit të Përgjithshëm vjetor të inspektimit për vitin 2015 u analizuan raportet vjetore të hartuara nga Inspektoratet Shtetërore/ trupa të tjera inspektuese për vitin 2015, për fushat e inspektimit që ato mbulojnë, duke bërë edhe vlerësimin e veprimtarisë së tyre.

Pas analizës së përgjithshme të sistemit, jepen edhe konkluzionet dhe rekomanimet për përmirësimin e punës, rritjen e efektivitetit dhe fuqizimin e Inspektorateve Shtetërore.

III. REFORMA NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT

Inspektorati Qendror, mbështetur në objektivat Strategjike për periudhën 2015-2017 dhe Planin e tij të Veprimit, ka zhvilluar aktivitetin për arritjen e objektivave, për të përmbushur misionin e vet të rritjes së efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Në vijim të reformës në sistemin e inspektimit dhe bazuar në konkluzionet e Raportit të Përgjithshëm të një viti më parë, Inspektorati Qendror ka rritur bashkëpunimin e tij me Inspektoratet Shtetërore, si dhe ka nxitur bashkëpunimin mes vetë inspektorateve shtetërore për të bërë të mundur bashkërendimin e aktivitetit të tyre inspektues.

Gjatë vitit 2015 Inspektorati Qendror ka zhvilluar aktivitete që kanë synuar rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore. Në këtë kuadër janë hartuar një sërë aktesh nënligjore, raporte mbikëqyrje, rregullore, manuale të cilat synojnë unifikimin e procedurave dhe dokumentacionit të inspektimit për të gjitha fushat dhe funksionet e inspektimit në juridiksionin e ligjit të inspektimit.

- Zbatimi i parimeve të ligjit për inspektimin

Inspektorati Qendror në zbatim të parimit të proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, si dhe pikës 7, neni 48 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar draft VKM për “Rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit”. Në vazhdim të zbatimit të Reformës në Inspektime, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, ky projektvendim synon të japë rregullat e përgjithshme bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në përputhje me parimin e proporcionalitetit, gjatë procesit të inspektimit, për mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që inspektohen, në mënyrë që dënimi administrativ të jetë përgjithësisht i njëjtë e të sigurojë trajtim të drejtë dhe të barabartë për subjektet e inspektimit dhe njëkohësisht të shmangë rreziqet që mund t’u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë të parashikuara me ligj.

Gjithashtu, miratimi i këtij projektvendimi do të vendosë një barazi dhe transparencë në marrjen e vendimit përfundimtar nga inspektorët të cilët kanë kryer procesin e inspektimit. Kjo synon të arrijë një trajtim të njëjtë dhe të barabartë për subjektet e inspektimit për të përmirësuar performancën e inspektorëve dhe kontribuar në rritjen ekonomike të dëshiruar.

- Unifikimi i metodologjisë, procedurës dhe dokumenteve të inspektimit

Për të përmirësuar procesin e unifikimit të dokumenteve që përdoren gjatë procesit të inspektimit, në zbatim të ligjit për inspektimin, u bënë përmirësimet e nevojshme në dokumentet standarde të inspektimit të cilat u miratuan dhe hyjnë në fuqi me Urdhrin nr. 58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014, “Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, të Inspektorit të Përgjithshëm. Në zbatim të këtij Urdhri, 2 Inspektorate Shtetërore dhe 4 trupa inspektuese (Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Ujërave, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave,) përshtatën ndryshimet në dokumentacionin e tyre sipas fushave specifike të inspektimit me ato unike, i cili do të bëjë të mundur dokumente unike inspektimi për të bashkërenduar veprimtaritë e Inspektorateve Shtetërore dhe kryerjen e inspektimeve të përbashkëta me qëllim që të ulët kosto administrative e subjekteve të inspektimit në lidhje me këtë aktivitet.

Për zbatimin e parimit të programimit të inspektimit mbi bazë risku, është punuar për hartimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut, si dhe rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve, miratuar respektivisht me Urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut” dhe Urdhrin nr. 5, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”, të Inspektorit të Përgjithshëm. Hyrja e këtyre koncepteve të reja do të sjellë një planifikim më të mirë të burimeve njerëzore që kanë në dispozicion inspektoratet shtetërore, duke përqendruar inspektimin në ato subjekteve të inspektimit të cilat paraqesin rrezikshmëri më të lartë në sigurinë publike.

Për zbatimin e parimit të efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, është punuar për hartimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit dhe raportimit të tyre, miratuar me Urdhrin nr. 7, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit e raportimit të tyre”, të Inspektorit të Përgjithshëm.

Në funksion të procesit të inspektimit është hartuar manuali i përgjithshëm i inspektimit në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 13, datë 23.04.2015, “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, të Inspektorit të Përgjithshëm. Manuali i Përgjithshëm i Inspektimit përcakton politikat, standardet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga strukturat e inspektorateve shtetërore dhe vendore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese sipas ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ky manual ofron një formë të metodologjisë, rregullave dhe procedurave unike që duhet të ndiqen për planifikimin, kryerjen e raportimin e inspektimit, si dhe korrigjimin e shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre, të lëna në përfundim të inspektimit.

Në zbatim të detyrave, Inspektorati Qendror ka kryer trajnime të nevojshme për tre Inspektorate Shtetërore, respektivisht Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, (ISHSH) me pjesëmarrjen e 43

inspektorëve; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, (AKU) me pjesëmarrjen e 269 inspektorëve; Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, (ISHMP) me pjesëmarrjen e 28 inspektorëve, për rritjen e kapaciteteve për inspektorët shtetërorë mbi procedurat e reja të inspektimit, si dhe përdorimin e portalit “e-Inspektimi” nëpërmjet paketave portabël për ata inspektorë që i përdorin ato. Për të vlerësuar veprimtarinë dhe punën e inspektorateve shtetërore dhe inspektorëve vendorë, janë hartuar rregulla së përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre.

Pra, zbatimi i reformës ka sjellë përmirësime të të gjithë sistemit të inspektimit. Reforma ka synuar që nëpërmjet planifikimit mbi bazë risku, standardizimit të procedurës së inspektimit dhe informatizimit nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”, të rrisë transparencën e procesit dhe të parandalojë mundësinë e marrëveshjeve informale e korruptive të inspektorëve shtetërorë dhe subjekteve të inspektimit në të gjitha fazat e procesit të inspektimit, që nga planifikimi i inspektimit e deri tek apelimi i masave administrative të vendosura nga inspektorët.

- Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës për veprimtarinë e inspektimit

Inspektorati Qendror, në përmbushje të funksioneve të tij, ka kryer mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore/trupa të tjera inspektuese, për zbatimin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese pranë subjekteve të inspektimit, në raport me ligjin e inspektimit dhe ligjeve të tyre sektoriale.

Aktivitet mbikëqyrës është realizuar pranë tetë inspektorateve shtetërore/trupa të tjerainspektuese përkatësisht Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Nëpërmjet kësaj mbikëqyrje është vlerësuar veprimtaria e inspektorateve shtetërore, ku janë identifikuar edhe disa problematika, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin dhe unifikimin e veprimtarisë inspektuese në të gjithë sistemin e inspektimit.

Nga mbikëqyrja u konstatua se përgjithësisht gjatë procesit inspektues janë zbatuar kërkesat ligjore sipas ligjit të inspektimit dhe ligjeve të posaçme, por më hollësisht janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të mbikëqyrjes.

Me qëllim përmirësimin e kësaj veprimtarie inspektuese të këtyre inspektorateve shtetërore, Inspektorati Qendror rekomandoi të përmirësohen:

- a) programimi i veprimtarisë së inspektimit nga inspektoratet shtetërore duhet të hartohet bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin për inspektimin periodik sipas kërkesave specifike të ligjeve të posaçme;
- b) të përdorin formatet standarde të miratuara të veprimtarisë inspektuese;
- c) çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit, si dhe çdo akt administrativ i nxjerrë prej tyre, i cili ka lidhje me veprimtarinë inspektuese, duhet të këshillohet më parë nga Inspektorati Qendror;

- d) citimin e saktë të bazës ligjore në të gjitha dokumentet e përdorura gjatë procesit të veprimtarisë inspektuese;
- e) rishikimin e disa akteve ligjore në ato fusha ku kjo ka dalë si domosdoshmëri;
- f) përditësimin e manualeve dhe rregulloreve teknike;
- g) krijimin e “Organit epror” të ankimimit sipas ligjit për inspektimin;
- h) krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të gjobave deri në ekzekutimin e tyre.

Forcimi i rolit mbikëqyrës të Inspektoratit Qendror për zbatimin e ligjit të inspektimit dhe ligjeve sektoriale nga inspektoratet shtetërore ka sjellë përmirësim lidhur me programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, si dhe ka siguruar standardizimin e veprimtarisë inspektuese duke rritur përgjegjshmërinë dhe efektivitetin në zbatim të ligjeve në fuqi.

Gjatë vitit 2015 numri i përgjithshëm i proceseve të inspektimit të kryera nga të gjithë inspektoratet shtetërore/trupa të tjera inspektuese është **155.966 inspektime**; ndërsa numri i përgjithshëm i masave administrative të marra prej tyre shkon në **5.708 masa administrative**.

- Implementimi i Portalit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”

Për përdorimin e portalit “e-Inspektimi”, fillimisht janë përzgjedhur tre inspektorate pilot, (1) *Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore*; (2) *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë*; (3) *Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria rajonale Tiranë* dhe tashmë *Autoriteti Kombëtar i Ushqimit* është drejt përfundimit të marrjes së masave të nevojshme për përdorimin e këtij portali.

Për kryerjen e inspektimeve on-line, AKU gjatë vitit 2015 është pajisur me 223 paketa portabël inspektimi, të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit.

ISHPSHSH, Dega Rajonale Tiranë ka filluar përdorimin e sistemit unik të inspektimeve “e-Inspektimi” dhe në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror ka bërë një punë të mirë si në standardizimin e dokumentacionit inspektues, ashtu edhe në atë të implementimit të portalit për të bërë të mundur kryerjen e inspektimeve on-line dhe megjithë problematikat e hasura për vitin 2015 ka hedhur në sistem planin vjetor, planet mujore dhe rreth **916** çështje on-line, ndërsa degët e tjera rajonale nuk kanë nisur akoma procesin e inspektimit on-line.

Inspektimet e kryera on-line nëpërmjet këtij portali kanë shkurtuar afatet kohore të qëndrimit të inspektorëve pranë subjektit, kanë rritur efektivitetin dhe transparencën, duke kontribuar në minimizimin e abuzivizmit në veprimtarinë inspektuese nga ky inspektorat.

Gjithashtu, për këtë inspektorat është bërë edhe trajnimi (trainer of trainers) për çdo drejtori rajonale.

Për Inspektoratet Shtetërore ISHSH, ISHMP, dhe AKU është realizuar implementimi në sistem i dokumenteve standarde sipas fushave të tyre të inspektimit dhe listë-verifikimi/cheklistë, por akoma nuk janë përdorues të këtij sistemi.

ISHSH, nuk ka filluar akoma inspektime on-line, edhe për arsye se të gjitha subjektet shtetërore

janë pjesë e platformës së DPT, e cila ende nuk shkëmben të dhëna me portalin “e- Inspektimi”, por jemi në proces bashkëpunimi.

AKU, do të jetë përdorues i portalit, sapo të implementohen në portal kategorizimi i subjekteve sipas kërkesave specifike të ligjit të tyre sektorial.

Procesi i inspektimeve on-line u shty në afate kohore për shkak se këto inspektorate ishin edhe pjesë e fushatës kundër informalitetit në ekonomi.

Është bërë implementimi i dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve edhe për Inspektoratin Shtetëror të Arsimit (ISHA).

Vijon procesi i përmirësimit të moduleve ekzistuese të RBI dhe statistikave, për të cilën janë zhvilluar edhe disa takime me kompaninë zhvilluese ikubINFO, në zbatim të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit.

Sistemi “e-Inspektimi”, si pjesë e platformës qeveritare të ndërveprimit ka finalizuar ndërveprimin me sistemin e QKR-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) dhe sistemin e QKL-së (Qendrës Kombëtare të Licensimit) për shkëmbimin e të dhënave midis tyre.

Është në proces ndërveprimi sistemi “e-Inspektimi”, me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për marrjen e të dhënave për institucionet shtetërore objekt inspektimi dhe sistemin e Gjendjes Civile për identifikimin e personave nën 18-vjeç që janë të punësuar.

Ndër vështirësitë e hasura për implementimin e portalit nga Inspektoratet pilot përmendim; mungesën e kapaciteteve të burimeve njerëzore në fushën e IT, si suport mbështetës për funksionimin e portalit “e-Inspektimi”; integrimin e portalit “e-Inspektimi” me sistemet e tjera; riorganizimin e inspektorateve; aksesimin e përdoruesve sipas roleve; mungesa në disa raste e listës së update të subjekteve të marra nga QKR; mungesa e shërbimit të internetit Wireless.

Inspektorati Qendror mban të përditësuar Regjistrin Kombëtar të inspektorëve shtetërorë dhe e ka publikuar në faqen zyrtare të IQ dhe në portalin “e-Inspektimi”. Ky regjistër bazohet në listën emërore të inspektorëve në detyrë dhe përditësohet rast pas rasti sipas të dhënave të dërguara nga Inspektoratet Shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese.

Deri në fund të vitit 2015, janë pajisur me kartën e inspektorit rreth 1000 inspektorë.

Ndër pritshmëritë për vitin 2016 përmendim: kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”, për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nga të gjithë degët rajonale, Inspektoratin Shtetëror të Shëndetësisë dega rajonale Tiranë, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, dega rajonale Tiranë, Durrës dhe Elbasan, si dhe AKU; vazhdimësia e projektit për pajisjen e inspektorateve shtetërore me kite portabël inspektimi; bashkërendimin e inspektimeve, (join inspection) për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që ato kryejnë për të rritur transparencën e veprimtarisë inspektuese drejt qasjeve antikorruptive.

Platforma qeveritare e ndërveprimit është një platformë kyçe e realizimit të ndërveprimit të sistemeve të institucioneve të Administratës Publike. Ajo është në zhvillim të vazhdueshëm, meqenëse edhe kërkesat për ndërveprim mes sistemeve rriten gjithmonë e më shumë.

Në kuadër të realizimit të ndërveprimit të sistemeve, projekt i ndërmarrë nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), Inspektorati Qendror ka finalizuar ndërveprimin me sistemin e QKR-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) dhe sistemin e QKL-së (Qendrës Kombëtare të Licensimit).

Është në proces ndërveprimi i sistemit “e-Inspektimi” me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe sistemin e Gjendjes Civile (DPGJC).

- Vlerësimi dhe testimi i inspektorëve shtetërorë

Gjithashtu po vazhdon puna për unifikimin e procedurave të vlerësimit mbi bazë performance për inspektoratet shtetërore. Meqenëse kapacitetet njerëzore janë të dobëta, gjë e cila është edhe një nga arsyet e mosfunksionimit të plotë të ligjit të inspektimit, Inspektorati Qendror po punon për hartimin dhe zbatimin e procedurave të trajnimit dhe certifikimit të inspektorëve. Aktualisht në këtë drejtim ekziston një ngërç me Departamentin e Administratës Publike, si rrjedhojë e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, për hartimin dhe miratimin e rregullores për intervalet e testimit periodik të inspektorëve, rregullat e hollësishme për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë. Kjo rregullore propozohet në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke plotësuar kuadrin ligjor lidhur me testimin e inspektorëve shtetërorë.

RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT


1) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, (ISHPSHSH), vepron në bazë të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë e shëndetit në punë”, i ndryshuar dhe ka 12 degë rajonale


sipas qarqeve me 98 inspektorë me një mesatare 110 inspektime në vit për çdo inspektor. ISHPSHSH është përgjegjës për inspektimin e strukturave të shërbimit social rezidencial, jo rezidencial, publik dhe privat për respektimin e standardeve ligjore të miratuara.

Gjatë vitit 2015 janë kryer **7627** inspektime në subjekte private e shtetërore, realizuar si inspektime të planifikuara, inspektime për shkak ankese apo inspektime për shkak aksidenti në punë. Në fakt planifikimi i inspektimeve për vitin 2015 në total nga ISHPSHSH ka qenë për 10.760 inspektime, por realizuar në fakt në fund të vitit janë 7627 të tilla.

Inspektime të programuara	6118	-
Riinspektim (zbatim i detyrave të lëna)	661	
Realizuar në turn të dytë	318	
Realizuar në turn të tretë	6	
Realizuar në ditët e pushimeve	35	
Për punëmarrës nën 18-vjeç	32	
Inspektime për aksident në punë	121	
Inspektime për shkak ankese	308	
Inspektime Rastësore	28	
Totali	7627	



Inspektimet të ndara sipas llojit të aktiviteteve ekonomike rezultojnë sipas grafikës sa më poshtë:



Mos realizimi i këtij numri është si rezultat i përfshirjes së trupës inspektuese në operacionin anti-informalitet, ku vetëm nga grupet e punës, pjesë e të cilave ishin dhe inspektorët e punës janë realizuar 30.736 kontrolle. Ndërkohë që rezultatet e inspektimeve për periudhën Janar-Gusht ku është punuar sipas inspektimeve normale, tregojnë tejkalim të planifikimit. Për këtë periudhë planifikimi ka qenë për 6860 inspektime dhe janë realizuar 7115 të tilla, duke shënuar një tejkalim prej 255 inspektimesh.

Gjithashtu, janë realizuar **667** inspektime në subjekte me aktivitet në hoteleri turizëm gjatë muajve Korrik-Gusht.

Si rrjedhojë, janë realizuar **30.736** kontrolle të përbashkëta me inspektorët tatimorë në kuadër të operacionit mbarë kombëtar për luftën ndaj informalitetit.


Numri i lartë i subjekteve të kontrolluara nga inspektorët e punës, përkthehet në numër subjektesh, punëdhënësish e punëmarrësish të informuar mbi:

1. Zbatimin e dispozitave ligjore të diktuar nga Legjislacioni i Punës;
2. Këshilla teknike punëdhënësve e punëmarrësve mbi mbrojtjen sociale e sigurinë në punë.

Ankesat të ndara sipas përshkrimit të rastit ose pretendimit të ankuesit:

- | | | |
|----|--|------------|
| 1. | Cënim i marrëdhënieve të punës | 145 ankesa |
| 2. | Kushte pune të pasigurta dhe mos njoftim aksidenti në punë | 10 ankesa |

3.	Ndërprerje të menjëhershme të marrëdhënieve të punës	63 ankesa
4.	Punësim të paligjshëm (ilegal)	56 ankesa
5.	Mos pagesa e pagave dhe kontributeve shoqërore	84 ankesa
6.	Të tjera	46 ankesa
TOTALI		404 ankesa



Tashmë inspektorët e punës kanë në dorë “Manualin e trajtimit të ankesave”, ku përcaktohet metodologjia që do të ndiqet. Konstatohet një përmirësim shumë i ndjeshëm në punën që bëhet në këtë drejtim nga inspektorët, si në trajtim apo në praktikë të mbajtur.

Analizimi i praktikave të mbajtura nga inspektorët e punës për trajtimin e ankesave ka orientuar qartazi planifikimin për inspektime të kryera në vazhdimësi. Duke qenë se inspektori i punës ka detyrimin e trajtimit të ankesës jo vetëm për sqarimin e situatës së punëmarrësit të ankimuar, por edhe për të parë nëse pranë këtij subjekti nëse ekziston një fenomen i tillë që prek një numër të caktuar punëmarrësish, si dhe trajtimi i tyre me profesionalizëm sjell mos përsëritjen e tyre.

Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë vitit 2015, nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:

1.Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	7627
2.Vende pune të inspektuara mesatarisht punëmarrës/subjekt	151102 19.8
3.Subjekte private të inspektuara	7567

4.Vende pune të inspektuara në subjektet private	144288
mesatarisht punëmarrës/subjekt	19
5.Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	4431
6.Punëmarrës informal të evidentuar (jo operacion)	1227
7.Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH (procedurë e re statistikore dhe shkresore filluar nga muaji Korrik 2015)	550
8.Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	156
9. Punëmarrës të huaj të evidentuar	1739
10. Punëmarrës të huaj, pa leje pune	15
11. Subjekte për të cilët është mbajtur masë urgjente (për marrëdhënie pune) (procedurë e re statistikore dhe shkresore filluar nga muaji Korrik 2015)	191
12. Subjekte për të cilët është marrë masë urgjente (për siguri në punë) (procedurë e re statistikore dhe shkresore filluar nga muaji Korrik 2015)	4
13. Inspektime për shkak Ankese	308
14. Inspektime për shkak Aksidenti	121
15. Punëmarrës të aksidentuar	130
16. Subjekte të sanksionuara	122

Mesatarisht numri i inspektimeve realizuar nga çdo inspektor pune i çdo dege rajonale gjatë vitit 2015, është 321 duke përfshirë këtu edhe kontrollet e ushtruara në kuadër të operacionit antiinformalitet.

Praktika e mirë konceptuar me përdorimin e “masës urgjente” për punëmarrës informal të evidentuar, ka çuar në shmangien e burokracive shkresore, duke synuar në formalizimin në kohë reale të të punësuarve informal evidentuar në punë. Kjo praktikë e futur rishtas që nga Korriku i vitit 2015, është zbatuar dhe ndjekur me korrektësi sidomos nga DR Vlorë, Tiranë, Korçë, Dibër e Durrës. Mesatarisht masa urgjente është përdorur 2 herë gjatë vitit nga një inspektor pune.


Numri i subjekteve të sanksionuara gjatë inspektimeve në vitin 2015 është 122, me vlerë totale 35.196.000 lekë, ku: numri më i madh i subjekteve për të cilët është aplikuar masa e sanksionit për shkeljet ligjore të evidentuara, është në inspektimet e programuara dhe inspektime për shkak ankese.

36 gjoba me vlerë	6.990.000 lekë	në inspektimet e Programuara
24 gjoba me vlerë	8.620.000 lekë	në inspektimet Tematike
26 gjoba me vlerë	4.966.000 lekë	në inspektimet për Aksident
36 gjobë me vlerë	14.620.000 lekë	në inspektimet për shkak Ankese

Grafiku i mëposhtëm jep në përqindje numrin e subjekte të sanksionuara sipas llojit të inspektimit.

Subjekte të sanksionuara sipas llojit të Inspektimit

■ Inspektime të Programuara ■ Inspektime Tematike
■ Inspektime për Aksident ■ Inspektime për shkak Ankese



Gjatë vitit 2015 e në vazhdim, po ndiqen 24 procese gjyqësore që janë për gjoba ndaj subjekteve, nga të cilat 10 janë fituar nga institucioni duke lënë në fuqi sanksionin dhe duke konfirmuar punën e mirë dhe korrekte të bërë nga institucioni, 12 janë në Gjykatën e Apelit Administrativ, 2 janë humbur duke shfuqizuar një gjobë me vlerë 44.000 lekë dhe një gjobë prej 220.000 lekësh.

Pranë Sektorit të Inspektimit të Sigurisë në Punë nga Janar 2015 - Dhjetor 2015, janë raportuar 125 raste të aksidenteve në punë, ku kanë mbetur të aksidentuar 133 punëmarrës, prej të cilëve 28 kanë humbur jetën.

Nga 125 punëmarrës të aksidentuar, 14 prej tyre janë femra dhe 111 meshkuj. Femrat e aksidentuara janë me pozicion pune punëtore, në subjektet me aktivitet prodhim, shërbime dhe telekomunikacion.

Mosha mesatare e punëmarrësve të aksidentuar është 43 vjeç. Punëmarrësit e aksidentuar, përveç rasteve me pasojë vdekje, kanë pësuar kryesisht diegie në fytyrë dhe këmbë, dëmtim të dorës, frakturë në shpinë apo këmbë, shembje trupore etj. Të aksidentuarit në fjalë përgjithësisht ishin me pozicion pune punëtor, zjarrmëtar, elektrikist, saldator, vagonist, mekanik, shofer.

Ndaj 18 subjekteve janë vendosur masa administrative gjobë për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, apo mosnjohim të aksidentit në punë pranë ISHPSHSH-së. Në pjesën tjetër të rasteve janë vendosur dënime administrative paralajmërim për gjobë, si dhe lënia e detyrave përkatëse me afatet respektive.

Janë regjistruar 9 të aksidentuar në rrugë, si aksidente në punë, 2 nga të cilët kanë humbur jetën. Këtu janë përfshirë, si rastet kur punëmarrësi është aksidentuar gjatë linjës së drejtpërdrejtë nga banesa për në punë, si edhe rastet kur punëmarrësi po kryente punën sipas përshkrimit të saj dhe në këtë kohë është goditur nga një automjet.

Aksidentet që lidhen direkt me punën, duke përjashtuar aksidentet në miniera dhe në rrugë, përbëjnë 63.6% të rasteve të aksidenteve të ndodhura. Kjo është dhe shifra reale e punëmarrësve të aksidentuar gjatë kryerjes së punës sipas pëshkrimit të saj, pasi kujtojmë këtu që aksidentet në miniera dhe ato në rrugë, nuk janë në kontroll të drejtpërdrejtë të inspektorëve të punës.

Subjektet në të cilat kanë ndodhur aksidente në punë janë sanksionuar me gjobë nga ana e inspektorëve të punës, si dhe janë lënë detyra konkrete për bërjen e vendeve të punës më të sigurta.

Këto aksidente përgjithësisht janë njoftuar në kohë nga subjektet pranë zyrave të ISHPSHSH-së, përveç pak rasteve, për të cilët është vendosur sanksion, që i është shtuar masës së gjobës që do të merrte subjekti për shkelje të rregullave të sigurisë në punë.

Gjatë hetimit të aksidenteve, inspektorët e punës kryesisht kanë konstatuar shkeljet e mëposhtme:

- Moszbatim i rregullave të sigurimit teknik, etj.
- Mosnjoftimi nga punëdhënësi për aksidentin e ndodhur, sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.
- Mosmarrja e masave mbrojtëse kolektive.
- Mospajisja me mjete mbrojtëse individuale nga ana e punëdhënësit dhe në rastet kur janë dhënë, mospërdorimi i tyre gjatë punës nga punëmarrësit.

Mungesa e informimit dhe këshillimit të punëmarrësve

2) Ministria e Shëndetësisë


Ministria e Shëndetësisë, në fushën e juridiksionit që mbulon përfshin Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, (ISHSH), ushtron veprimtarinë e tij bazuar në VKM nr. 241, datë 27.03.2013 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”. Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik.


Viti 2015 është viti i parë i aktivitetit të ISHSH-së me struktura të ngritura në të gjitha qarqet e vendit. Zbatimi i planit të vitit 2015 është bërë duke pasur në mendje krijimin dhe funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave të popullatës për një administratë publike në shërbim të tyre. Gjithashtu zbatimi i planit të vitit 2015 është edhe rezultat i një procesi të frytshëm bashkëpunimi me strukturat ekzistuese të Ministrisë së Shëndetësisë duke u bazuar në përvojën më të mirë të tyre në vite. Gjatë vitit 2015 strukturat e ISHSH në qarqe dhe ai qendror kanë kryer në total **27 550** inspektime në respektim të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Numri më i madh i inspektimeve është kryer nga ISHSH dega Tiranë me 5 801 inspektime dhe numri më i vogël i inspektimeve është kryer nga ISHSH dega Lezhë me 1 135 inspektime. Ky ndryshim në numër inspektimesh shpjegohet me ndryshimin e subjekteve të inspektimit mes të dy qarqeve, fakt i cili është pasur parasysh edhe në numrin e inspektorëve të punësuar pranë çdo qarku ku Tirana

si qarku më i madh ka numrin më të madh të inspektorëve. Në momentet kryesore të inspektimeve të vitit 2015 mund të përmenden:

- Monitorimi për zbatimin e ligjit nr. 9636, i ndryshuar “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, si një nga arritjet më të rëndësishme nga ana e ISHSH-së për vitin 2015.
- Inspektimet e bëra për shëndetin riprodhues duke bërë edhe një vlerësim të nevojave që ka vendi për këtë pjesë të kujdesit shëndetësor për të parë zbatimin që ka ligji, por edhe moskrijimin e një boshlleku në këtë pjesë të kujdesit shëndetësor.
- Inspektimet e bëra për zbatimin e ligjit nr. 8528, i ndryshuar “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”;
- Inspektimet e bëra për zbatimin e ligjit nr. 9928, i ndryshuar, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”;
- Inspektimet e bëra për laboratorët publike dhe jo publike;
- Inspektimet dhe puna e kujdesshme sidomos gjatë sezonit turistik të verës në funksion të higjenës për të patur sa më pak pasoja;




Inspektimet sipas fushave të Veprimtarisë



Një punë e mirë është bërë edhe në inspektimin e dedikuar për zbatimin e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, i ndryshuar, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”. Në këtë kuadër u kryen 22.125 inspektime në të gjitha qarqet e vendit si më poshtë:

Inspektime në kuadër të ligjit kundër duhanit



Nga përvoja shumë pozitive e bashkëpunimeve të vitit 2015 mund të përmenden bashkëpunimet:

Për zbatimin e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, i ndryshuar, “Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”:

-  Policinë e Rendit
-  Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU)
-  Inspektoratin Shtetëror të Arsimit (ISHA)
-  Inspektoratin e Punës (ISHPSHSH)
-  Shqipëria Jo Duhanit

Aksioni Kundër Informalitetit:

-  Drejtorinë e Tatim Taksave (ISHSH bashkëpunoi me 110 Inspektorë në këtë aksion në një periudhë kohore katër mujore, Shtator – Dhjetor 2015).

Subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm:

-  Inspektorati Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP)
-  Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)
-  Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit

Për zbatimin e ligjit nr. 8528, “Për nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Gji”:

-  UNICEF
-  IBFAN
-  ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISE (OBSh)

Objektivat për vitin 2016

Viti 2016 e gjen Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor një institucion të konsoliduar dhe me përvojën e nevojshme që të garantojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Objektivat kryesore të ISHSH për vitin 2016 janë:

- ✓ Përmirësimi i kuadrit ligjor për fushën e shëndetit publik;
- ✓ Ngritja e njësive kufitare të inspektimit;
- ✓ Realizimi i vlerësimit të riskut në terren nëpërmjet analizave laboratorike të mostrave;
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me institucione të njëjta ligj zbatuese vendase dhe të huaja;
- ✓ Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- ✓ Inspektimet sipas planit vjetor 2016.


2. Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), vepron në zbatim të ligjit nr. 105/2014, datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015 “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”. AKBPM kryen inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike që kanë të bëjnë me vendosjen në treg, tregtimin me shumicë dhe pakicë, si dhe kushtet e ruajtjes së barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse e materialeve ambalazhuese, tregtimin dhe eksportimin e barnave të prodhuara nga fabrikuesit vendas, importin e barnave, autorizimin për import.

Gjatë vitit 2015, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ka realizuar veprimtarinë inspektuese dhe kontrollin mbi barnat e vendosura në treg, në drejtimet si më poshtë:

- Pranimin dhe vlerësimin e kërkesave për import dhe eksport të barnave nga subjektet farmaceutike, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës;
- Ndjekjen e procedurave të përcaktuara për importin e barnave, lëndëve të para dhe atyre ndihmëse, si dhe verifikim fizik të barnave të importuara pranë ambjenteve të subjekteve farmaceutike;
- Pajisjen e subjekteve me pulla kontrolli dhe autorizim përdorimi, për barnat e importuara dhe ato të prodhuara në vend;
- Kontrollin e subjekteve farmaceutike (depo, farmaci, agjenci farmaceutike dhe fabrikat e prodhimit farmaceutik) për zbatimin e legjislacionit në fuqi për barnat dhe shërbimin farmaceutik;
- Marrjen e masave administrative përkatëse: dënim me gjobë; bllokim dhe sekuestrim të barnave; konfiskim të barnave; propozim për heqje licence; në rastet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative;
- Ruajtjen dhe administrimin e barnave të sekuestruara dhe/ose të konfiskuara, në ambjentet e Agjencisë;
- Ndjekjen e procedurave për asgjësimin e barnave të sekuestruara dhe/ose të konfiskuara, kur ato janë jashtë standardeve të vendosura, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.


Bazuar në të dhënat e Sektorit të Inspektimit, për periudhën Janar – Dhjetor 2015 rezultojnë **2464** inspektime të ndara në:

- **629** Akt-kontrolle inspektimi në subjekte farmaceutike (depo farmaceutike, farmaci, agjenci farmaceutike);
- **1835** “Raport inspektori (kontrolli fizik-akt kontrolli) për barna të importuara dhe barna të prodhuara në vend;



Gjithashtu, gjatë vitit 2015, AKBPM ka marrë **93** masa administrative ndaj subjekteve farmaceutike dhe 63 sekuestre të barnave si vijon:

- ❖ Farmaci: në **80** raste dënime me gjobë dhe në **51** raste sekuestrim/konfiskim i barnave;
- ❖ Agjenci farmaceutike: në **3** raste dënime me gjobë dhe në **4** raste sekuestrim/konfiskim i barnave;
- ❖ Depo farmaceutike: në **10** raste dënime me gjobë dhe në **8** raste sekuestrim /konfiskim i barnave.



3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet vepron në zbatim të ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar, dhe ligjit Nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese” dhe ka mision kryesor përcaktimin e kushteve të mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar, në maksimum, të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese, si dhe monitorimin e rrezatimeve jojonizuese.

ZMR, përgatit dokumentet ligjore për mbrojtjen e punonjësve, publikut dhe mjedisit nga efektet e rrezatimeve, duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare të ANEA-s dhe Bashkimit Evropian (BE). Gjithashtu, kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim, në përputhje me ligjin


nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjet në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Në zbatim të rregullores Nr. 10 datë 07.01.2010 “Për licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”, si dhe në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2015, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, janë realizuar të gjitha inspektimet e planifikuara. Gjithashtu, inspektimi gjatë 2015 ka përfshirë dhe inspektimet jashtë programit, autorizimi i të cilave është bërë në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretë ose kur ka pasur një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nga një subjekt.

Gjatë vitit 2015, janë realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive.

Gjatë inspektimit bazuar në objektin e inspektimit, janë realizuar dhe matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është përcaktuar doza efektive vjetore për publikun dhe stafin.

ZMR, gjatë vitit 2015, ka realizuar 36 inspektime në subjekte shtetërore dhe 27 inspektime në subjekte private.



Në zbatim të udhëzimit nr. 676, datë 05.12.2008 “Për shkallën e penalizimit për shkeljet administrative të parashikuara në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizues”, i ndryshuar, gjatë vitit 2015, janë marrë 12 vendime për mbylljen e aktivitetit për shkak të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit të cituar më sipër. Gjatë këtij viti nuk është marrë asnjë vendim me gjobë.

Marrja e vendimeve nga ana e inspektorëve të ZMR-së, për mbylljen e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, është bërë në përputhje me ligjin dhe pasi janë vënë re shkelje nga ana e

subjekteteve, ose në rastet kur nuk janë zbatuar afatet e caktuara të lëna nga inspektori në procesverbal. Shumica e këtyre subjekteve janë grafi dentare dhe panoramex, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre pa licencë.

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka nisur bashkëpunimin me ISHSH, institucion i cili do të mbulojë verifikimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues dhe jojonizues nëse kanë licencë/aktmiratimi ose jo. ZMR-ja do të jetë përgjegjëse për inspektimin në lidhje me aspektet teknike të procesit .


KMR/ZMR, nuk ka filluar akoma procesin e inspektimit të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, që përfshin antenat celulare, kjo për arsye të mungesës së fondeve nga ana e Institutit të Shëndetit Publik për blerjen e pajisjeve të nevojshme për realizimin e inspektimit të burimeve të rrezatimit jojonizues.

3) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në fushën e juridiksionit që mbulon përfshin Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Inspektoratin Shtetëror të Ujërave:

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) u krijua me Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, dhe sipas VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, i ndryshuar, dhe me fonde të BE-së, Qeverisë Shqiptare, mbështetjen e ekspertëve të huaj. Struktura e këtij institucioni është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 119, datë 10.03.2014, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”. Aktualisht, funksionon si një institucion i konsoliduar me 12 Drejtori Rajonale dhe ka për mision: Të vendosë dhe të konsolidojë në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar, prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore, në sigurimin e prodhimit bujqësor, për parandalimin e impakteve negative të përdorimit të pesticideve, të farërave dhe plehrave të përdorimit për bimësinë.

Drejtoria e menaxhimit të riskut dhe koordinimit të inspektimit është përgjegjëse për koordinimin e gjithë procesit të inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore dhe të operatorëve të biznesit ushqimor, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe mbështetjen e Laboratorëve. Gjatë vitit 2015 ka kryer **79.629** inspektime, sipas fushave përkatëse.



Kjo drejtori kryen veprimtarinë sipas tre sektorëve në vijim:

- *Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Joshtazore dhe Operatorëve të Biznesit*, koordinon të gjithë procesin e inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë joshtazore dhe operatorëve të biznesit.

Në objektivat e vitit 2015, për këtë sektor ishin:

- Rritja e kërkesave për gjurmueshmërinë, si dhe implementimi i procedurave të vetëkontrollit sipas parimeve të HACCP³ për rritjen e cilësisë së inspektimeve;
- Hartimi i Planit vjetor për kontrollet zyrtare me bazë risku dhe marrjen e mostrave;
- Intensifikimin e inspektimeve për monitorimin e vazhdueshëm për cilësinë dhe sigurinë e prodhimit, ambalazhimit dhe tregtimit të miellit dhe nënprodukteve të tij, nivelin e jodit në kripë në të gjitha hallkat, ushqimeve të shpejta që lidhet me sigurinë ushqimore të vajit të përdorur për skuqje;
- OBU importues, tregtues, prodhues dhe përdorues të ujit mineral natyral dhe ujit mineral natyral me gaz karbonik të shtuar, fillimin e implementimit të procedurave të sistemit të vetëkontrollit (HACCP);
- OBU⁴ të regjistruar apo të paregjistruar, sipas qarqeve dhe bashkëpunimi me organizmat shtetërore përgjegjëse për regjistrimin e tyre;
- Forcimi i kërkesave për zbatimin e ligjit mbi etiketimin në shqip të produkteve ushqimore të importit, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe trajnimin e inspektorëve mbi zbatimin e kërkesave ligjore.

Puna e kryer gjatë vitit 2015 ka qenë koordinimi, mbështetja dhe inspektime të përbashkëta në Sektorë në Operatorët e Biznesit në Drejtoritë Rajonale të AKU-së. Për periudhën Janar-Dhjetor

³ Hazard analysis and critical control points.

⁴ Operatorët e Biznesit Ushqimor.

2015 janë kryer gjithsej **13 705 inspektime** tek OBU që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë ushqime me origjinë josh tazore. Janë vendosur masa administrative si: 1 784 paralajmërime, 126 gjobë me një vlerë prej 14 110 000 lekë, 54 subjekte me pezullim aktiviteti, si dhe janë bllokuar dhe asgjësuar 13 189.388 tonë mallra.

Gjatë kontrolleve zyrtare në OBU, janë konstatuar disa problematika në lidhje me zbatimin e kërkesave të legjislacionit. Për këto problematika janë marrë masa administrative referuar legjislacionit në fuqi për: kushtet higjeno-sanitare; etiketimin e produkteve ushqimore dhe evidentimin e tyre me afat përdorimi të kaluar; mungesën e dokumentacionit dhe mangësitë në sistemin e gjurmueshmërisë; zbatimin e kërkesave të planit të vetëkontrollit (HACCP); mosrealizimin e detyrave të lëna nga inspektimi paraardhës.

- Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit koordinon të gjithë procesin e inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe operatorëve të biznesit.

Objektivat për vitin 2015 kanë qenë kontrollet zyrtare me bazë risku dhe marrja e mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtja e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe plani i marrjes së mostrave, i cili është hartuar në përafrim me kërkesat e Rregullores (EC) Nr. 882/2004, Nr. 852/2004, Nr. 853/2004, dhe 854/2004, me qëllim, sigurimin e një metodologjie për përcaktimin e prioritetëve të kontrollit me bazë risku, duke përcaktuar frekuencën e përshtatshme të kontrolleve zyrtare në lidhje me nivelin e riskut, burimet e disponueshme dhe përcaktimin e objektit të kontrollit.

Puna e kryer gjatë vitit 2015. Sektori ka punuar në drejtimet e Planit të veprimit “Për kontrollin e Operatorëve të Biznesit Ushqimor, të cilët kryejnë procesin e therjes së kafshëve, si dhe në subjektet e tregtimit të mishit; monitorimin e procesit të therjes në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 125, dt 17.04.2012 “Për disa masa mbi koordinimin e kontrolleve në lidhje me procesin e therjes së kafshëve; planin e veprimit në Stabilimentet e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve me origjinë shtazore, siç janë: produktet e mishit (sallami me nitrite), mjalti, dateri, djathi, veza; planin e veprimit për OBU të cilët prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë produkte ushqimore në kuadër të sezonit turistik; inspektime bazuar në informacionet e marra nga Drejtoria e Vlerësimit dhe komunikimit të Riskut nëpërmjet sistemit RASSF. (Rast i reduktuar nga sistemi për copa xhami në kavanoz në acuge); inspektime të përbashkëta me DRAKU, në stabilimentet e peshkut të freskët dhe të përpunuar të cilët kërkojnë të drejtën për t’u pajisur me kodin CE për eksport të këtij produkti drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Për vitin 2015, janë kryer gjithsej **13 841 inspektime** tek OBU që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë ushqime me origjinë shtazore. Janë vendosur masa administrative prej të cilave 1145 paralajmërime, 99 gjobë me një vlerë prej 13 230 000 lekë, 63 subjekte me pezullim aktiviteti, si dhe janë bllokuar dhe asgjësuar 36 744 143 tonë mallra dhe 14 996 kokrra vezë.

- Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, për vitin 2015 ka patur si qëllim zbatimin me korrektësi të legjislacionit në fuqi, për të rritur sigurinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor, me qëllim ruajtjen e shëndetit të konsumatorit.

Gjatë vitit 2015 janë realizuar gjithsej 4 067 inspektime, si dhe janë vendosur masa administrative ku 36 prej tyre janë paralajmërime, 27 gjoba, 11 subjekte me bllokim aktiviteti dhe 23 bllokime të inputeve bujqësore.

Problematikat kryesore të konstatuara në tregtimin e PMB-ve me shumicë apo me pakicë, plehrave të përdorimit për bimësinë, prodhimin dhe tregtimin e MMSHB-ve janë në dokumentacion në regjistrin e shitjeve dhe blerjeve, të recetave për tregtimin e të PMB-ve, dëshmitë e aftësisë për përdorimin e PMB-ve “të rrezikshme” dhe me “rrezik të lartë”, çertifikata e regjistrimit, çertifikata e origjinës dhe ajo e analizës, etiketa e prodhuesit dhe tregtuesit jo të rregullta.

Si rezultat i përmirësimit të kuadrit ligjor, unifikimit të procedurave për kryerjen e inspektimeve dhe intensifikimit të tyre, këshillimit të vazhdueshëm të subjekteve, si dhe zbatimit të masave administrative, u arrit përmirësim i dukshëm i kushteve të ruajtjes së inputeve bujqësore në pikat e tregtimit, sistemimin dhe mirëmbajtjen e evidencave dhe dokumentacionit, tregtimin dhe plotësimin gradualisht me receta të PMB-ve “me rrezik dhe rrezik të lartë”.

- *Spektori i koordinimit të Inspektorëve në Pikat e kalimit kufitar, siguron zbatimin me përpikmëri të legjislacionit në të gjitha Pikat e kalimit kufitar. Në të gjitha Pikat e kalimit kufitar, në vitin 2015, janë kryer **48 016 inspektime** gjithsej, të ndara në 30 784 inspektime për produkte ushqimore dhe 17 232 për imputet bujqësore.*

- *Spektori i koordinimit dhe mbështetjes së laboratorëve konsiston në veprimtarinë e koordinimit, mbështetjen dhe inspektimin e Sektorëve të Shërbimeve Laboratorike të AKU-së, në të cilët kryhet analizimi laboratorik për kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe bimëve.*

Gjatë vitit 2015 u analizuan në total 12 472 mostra për 30 326 tregues përkatësisht analitikë fiziko-kimikë, mikrobiologjike, të shëndetit të kafshëve dhe të mbrojtjes së bimëve. Bazuar në të dhënat mbi origjinën e mostrave në 26% të rasteve ka qenë nga kontrollet zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar, në 19% të rasteve nga kontrollet zyrtare në terren dhe në 55% të rasteve kanë qenë analiza vetëkontrolli.

Inspektorati Shtetëror i Ujërave, ISHU, u krijua me VKM nr. 386, datë 06.05.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Ujërave”. ISHU ka si objekt të punës së vet: planifikimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së inspektimit; sigurimin dhe unifikimin e praktikave të inspektimit në shkallë vendi; informimin e publikut për veprimtarinë e inspektimit; sigurimin e mbështetjes teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit; përgatitjen e programit dhe raportit vjetor të inspektimit; zbatimin e aktet ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes së rezervave ujore për menaxhimin e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore; sigurimin e zbatimit të praktikave të unifikuara të inspektimit për burimet ujore në nivel qendror dhe rajonal.

Inspektimet gjatë vitit 2015 janë përqendruar në këto drejtime kryesore:

a) Në inspektimin e burimeve ujore

Në inspektimin e burimeve ujore është kërkuar zbatimi i kërkesave të Ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Nga inspektimet ka rezultuar se subjektet përdorues të ujit nuk janë pajisur me formularët e lejes së përdorimit të ujit dhe është lënë rekomandim të aplikojnë pranë AUB-ve për t'u pajisur me leje/autorizim për përdorimin e burimit ujor.

Gjatë inspektimeve është kërkuar të disiplinohet përdorimi i ujit të nxjerrë nëpërmjet pusçpimeve dhe që kërkon pajisjen me leje të përdoruesve të këtyre burimeve ujore, nga organet e menaxhimit të ujërave. Është konstatuar se në vendin tonë janë mijëra puse të çpuara në vite pa studime dhe pa leje. Kjo situatë duhet t'i nënshtrohet diskutimit dhe vendimarrjes nga KKKU për të vendosur si do të bëhet legalizimi i faktit, duke iu kërkuar subjekteve që kanë kryer punimet, dokumente të plota të parashikuara në ligjin sektorial.

b) Në shkarkimet në ujëra

Në zonat bregdetare janë inspektuar subjekte si: hotele, restorante, objekte banimi, etj. dhe është kërkuar që të detyrohen subjektet të lidhin lokalet e tyre të shërbimit me rrjetet e kanalizimeve sekondare, terciare dhe kolektorët kryesorë të impianteve të trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Për subjektet industriale në zona të tjera të vendit, subjekteve iu është kërkuar të bëjnë ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për funksionimin e tyre, në përputhje me kërkesat e veçanta, sipas degës së industrisë, së cilës i përket veprimtaria, të përcaktuara me VKM nr. 177, datë 31.03.2005 "Për Normat e Lejuara të Shkarkimeve të Lëngëta dhe Kriteret e Zonimit të Mjediseve Ujore Pritëse".


c) Në shfrytëzimin e inerteve lumore

Lidhur me shfrytëzimin e inerteve lumore, gjatë inspektimeve të subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore, u janë lënë detyra në procesverbalet e inspektimeve dhe është kërkuar zbatimi i kërkesave të nenit 44 të ligjit 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", deri sa të miratohen formularët e kërkesës për leje dhe rinovim sipas propozimit të KKKU. Në gjykimin e ISHU lejet e shfrytëzimit të zhavoreve duhen dhënë në rastet e rehabilitimit të shtretërve të lumenjve, në mbrojtjen e brigjeve të lumenjve, për të shmangur përmbytjet, për ndërtimin e objekteve strategjike me rëndësi kombëtare dhe për të shfrytëzuar inertet aty ku egziston mundësia.

Gjatë inspektimit të subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore, nga inspektorët rajonalë është kërkuar rehabilitimi i zonës së shfrytëzuar dhe i shtretërve të lumenjve sipas kushteve të lejes së shfrytëzimit.

Gjatë vitit 2015 ISHU ka kryer gjithsej 397 inspektime të ndara në:

a. Inspektime për shfrytëzim inertesh	14
b. Inspektime për përdorim të burimit ujor	300
c. Inspektime për shkarkimet në ujëra	83



4) Ministria e Mjedisit

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, (ISHMP), ushtron funksionin e tij në bazë të VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, në dy funksione inspektimi, të cilat mbulohen nga drejtoritë e mëposhtme:

- a) Drejtoria e Inspektoratit të Mjedisit
- b) Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore

Drejtoria e Inspektoratit të Mjedisit (DIM), gjatë vitit 2015, ka realizuar inspektive të përqendruara në drejtim të:

- Zbatimit të kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese;
- Zbatimit të kushteve të lejes mjedisore të subjekteve që shfrytëzojnë burimet natyrore, në mënyrë të veçantë guroret, minierat dhe subjektet me aktivitet shfrytëzimi të naftës dhe gazit;
- Parandalimit të ndotjes akustike nga aktivitetet që gjenerojnë zhurmë në mjedis;
- Parandalimit të shkarkimeve të ujërave të ndotura të patrajuara që derdhen në burimet ujore pritëse, në veçanti parandalimi i shkarkimeve të kundërligjshme në det gjatë sezonit turistik;
- Inspektimit të automjeteve në fund të jetës, zbatimi i kërkesave të Aktit Normativ;
- Kontrollit të subjekteve publike e private për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Kontrollit të subjekteve publike e private për menaxhimin mbetjeve spitalore;
- Inspektimit të subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore lidhur me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore;

- Identifikimit të subjekteve pa leje mjedisore, kontrollin e tyre dhe bashkëpunimi me Agjencitë Rajonale të Mjedisit për pajisjen e këtyre subjekteve me lejen përkatëse mjedisore. Janë identifikuar rreth 1500 subjekte të cilave iu është lënë detyrë të aplikojnë për leje mjedisi.

Për realizimin e objektivave të mësipërme ka patur bashkëpunim pozitiv ndërinstitucional me Policinë e Shtetit, me strukturat e Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si dhe Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Në bazë të frekuencës së inspektimeve, analizës së riskut dhe prioriteteve të punës, inspektimet e programuara zënë 85% të volumit të inspektimeve dhe rreth 15% zënë inspektimet jo të programuara sipas parashikimit të ligjit të posaçëm dhe konkretisht verifikimit të ankimeve, flagrancës, incidenteve apo aksidenteve industriale.

Rreth 80% e inspektimeve janë kryer me autorizim inspektimi të posaçëm dhe 20% me autorizim, kryesisht ndaj subjekteve që kanë automjete dhe pjesë motorrike në fund të jetës për largimin e tyre sipas kërkesave të Aktit Normativ, si dhe për rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

Në të gjitha rastet e inspektimeve të programuara, për subjektet që ushtrojnë aktivitetin me leje mjedisore, është bërë paraprakisht njoftimi i inspektimit dhe janë ndjekur parimet, procedurat dhe kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.


Duke qenë se subjektet dërgojnë të dhënat e vetmonitorimit dhe analizat e shkarkimeve në ajër, tokë e ujëra, në dy raste është vendosur marrja e mostrave dhe referuar rezultatit të analizave të kryer në laboratorë të akredituar, i cili për disa elementë doli mbi normat e lejuara. Ndaj subjekteve përgjegjëse u mor masa administrative e dënimit me gjobë dhe pezullimi i pjesshëm i aktivitetit deri në plotësimin e kërkesave nënligjore dhe zbatimin e detyrimeve të lëna. Nuk është marrë asnjë masë urgjente e për rrjedhojë nuk ka patur asnjë ankim lidhur me to.

Lidhur me rritjen e kapaciteteve, ka filluar trajnimi i të gjithë inspektorëve të mjedisit në qarqe nga Projekti IBECA i Komisionit Evropian, ku përveç të gjithë komponentëve të inspektimit mjedisor është futur dhe krimi mjedisor, me qëllim përgatitjen e inspektorëve për pasqyrimin e rasteve që përbëjnë kundërvajtje penale mjedisore pas miratimit të ndryshimeve të Kreut të IV të Kodit Penal “Krimet kundër mjedisit” nga Parlamenti.

Gjatë vitit 2015 janë vendosur gjithsej 196 gjoba, nga të cilat:

- 62 gjoba me vlerë nga 10.000 deri në 50.000 lekë ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje mjedisore të tipit C me specifikim për zhurmat;
- 3 gjoba në vlerën 100.000 lekë për pengim apo moslejim të inspektimit;
- 110 gjoba në vlerën nga 300.000 - 500.000 lekë janë vendosur ndaj subjekteve:
 - ❖ Për ushtrim aktiviteti pa leje mjedisore të tipeve B ose C
 - ❖ Për moszbatim të kushteve të lejes mjedisore të tipeve B ose C
- 19 gjoba në vlerën 1.000.000 lekë për shkelje të kërkesave të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe akteve nënligjore për zbatim;

- 2 gjoba në vlerën 5.000.000 ndaj operatorëve industrialë lidhur me shkarkimin e ujërave të patrajtuara.



Gjatë vitit 2015, Komisionit të Ankimit të ISHMP ka shqyrtuar gjithsej **176** ankime të dënimeve administrative, nga të cilat:

- Janë pranuar **34** ankime në kuptim të nenit 146, pika b, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar;
- Janë rrëzuar **142** ankime në kuptim të nenit 146 pika a, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar.

Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore, (DIPP), me objekt të veprimtarisë së saj inspektimin e zbatimit të legjisllacionit rregullator në fushën e pyjeve e kullotave, faunës së egër, gjuetisë dhe bimëve medicinale e eterovajore, që synon parandalimin e dëmeve dhe mbrojtjen e fondit pyjor, kullosor e atij të gjuetisë, nga aktivitetet e paligjshme dhe ndëshkimin e kundravajtësve, gjatë vitit 2015 paraqet treguesit si më poshtë:

Për këtë periudhë, DIPP ka realizuar mbi 4200 inspektime në terren, ku janë proçeduar 519 kundravajtës, nga të cilët, 44 persona po ndiqen penalisht në rrethet: Korçë, Berat, Kukës, Elbasan, Tiranë, Vlorë, Dibër, Lezhë, Fier. Në 475 raste proçedimesh administrative janë vendosur 36,2 milionë lekë gjoba. Rajonet me numrin më të madh të procesverbaleve janë, Korça, Dibra, Elbasani, Shkodra, Durrësi etj.

DIPP ka sekuestruar në mbi 250 raste, sasi të konsiderueshme lëndë drusore, respektivisht lëndë punimi 274 m³ dhe dru zjarri rreth 2500 mst, si dhe 840 mst dru zjarri është në ruajtje si provë materiale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër. 76 % të kundravajteve janë kryer në pyje në pronësi shtetërore, 23 % komunale dhe 1 % private. Rajonet me volume sekuestrimesh më të mëdha janë: Shkodër, Korçë, Elbasan, Lezhë, Dibër, Tiranë.

DIPP ka kryer 26 proçedime në fondin kullosor me vlerë dëmi 415,9 milionë lekë dhe janë vendosur 1,1 milionë lekë gjobë për dëmtime në fondin kullosor. Rregjistri i ndërtimeve të paligjshme në fondin pyjor e kullosor është rifreskuar dhe i është përcjellë IKMT për kompetencë.

ISHMP, në bashkëpunim me IKMT, në rrethin e Krujës, kanë prishur 100 furra e gropa gëlqere. DIPP në bashkëpunim me DIM, ka inspektuar 20 HEC-e për zënie të fondit pyjor dhe janë lënë afate për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm qarqet : Korçë, Gjirokastrë, Shkodër, Berat, Dibër dhe mbi 40 subjekte minerare në Kukës.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme, është hartuar marrëveshja për kontrollin e transportit të paligjshëm të materialit drusor, si dhe janë ngritur në bashkëpunim postbllloqe fikse e të lëvizshme, si dhe hartuar marrëveshje bashkëpunimi me AKBN, për disiplinimin e subjekteve minerare.

250 inspekte janë realizuar në zonat e gjuetisë në Durrës, Kurbin, Shkodër, Fier, Vlorë etj. Janë proçeduar për gjueti të paligjshme 18 persona, janë vendosur 1.2 milion lekë gjoba, janë sekuestruar rreth 300 armë gjahu në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, si dhe janë sekuestruar mjete e pajisje të ndaluara për gjueti.

Gjatë këtij viti janë konstatuar gjithsej 141 raste zjarresh, nga të cilat në pyje 141 raste dhe në kullota 35 raste të tjera. Sipërfaqe e djegur në pyje rezulton 220 ha, nga të cilat 173 ha në trungishte halor, dhe 47 ha në pyje cungishte e shkurre (67% në pyje komunale). Në kullota janë djegur 30 ha në pronësi të komunave. Nga analiza e shkaqeve të rënies së zjarrit rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë të panjohura dhe nuk janë zbuluar autorët. Vëmendje e veçantë është treguar për Parqet Kombëtare, zonat e mbrojtura, pyjet e bregdetit, pyjet me rrezikshmëri të madhe në shfaqjen e zjarreve. Nëpërmjet shërbimeve shtesë, mbështetjes me mjete e forca pune, është bërë e mundur që këto zona të mbeten të paprekura nga zjarri.

Në zbatim të ligjit për inspektimin, janë hartuar materialet e plota për reformën institucionale të strukturave të kontrollit të Ministrisë së Mjedisit dhe iu janë përcjellë instancave përkatëse.

Këta tregues sintetikë tregohen në tabelën këtu poshtë:

Nr. Inspekti me gjithsej	Inspekti me për gjueti (raste)	Kundravajtje Penale	Kundravajtje Administrative	Material drusor i sekuestruar m ³	Të dhëna operative për zjarret në pyje e kullota.

		Raste	Vlera e dëmit (000/lekë)	Raste	Vlera e dëmit (000/lekë)	Vlera e gjobës (000/lekë)	Raste	Gjithsej m ³	Gjithsej raste	Sipërfaqe e djegur në pyje (ha)
4500	250	44	362 168	475	6 161 326	36 195	253	1741	141	240

5) Ministria e Punëve të Brendshme

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), është krijuar dhe ushtron aktivitetin e vet në bazë të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 893, datë 04.11.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka për mision dhe ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në këto fusha:

- në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim;
- kontrollon zbatimin e dispozitave të ligjit për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme në nivel të qeverisjes vendore;
- kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore;
- kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg;
- kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karriera të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit.

IKMT-ja organizohet në dy nivele: në nivelin qendror dhe atë rajonal nëpërmjet degëve Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Sarandë, Lushnjë, Kukës, Shkodër.


Drejtoria e Inspektimit, Mbikëqyrjes së IKMT dhe Planifikimit është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standardeve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, mbikëqyrjen dhe kontrollin ndaj inspektorateve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore, inspektimin e materialeve dhe produkteve të ndërtimit që hidhen në treg, inspektimin e shfrytëzimit të karriera të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit.

Degët rajonale të IKMT-së e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin rajonal përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në atë rajon.

Përveç këtyre detyrave, IKMT u vjen në ndihmë e mbështetje me mjete e forca një sërë institucioneve të tjera për ekzekutim vendimesh, ku konkretisht përmendim Inspektoratet Vendore pranë Njësive Vendore, ARRS, Shërbimet Përmbartimore, etj.

Në zbatim të detyrave dhe përgjegjësiqe që ligji organik dhe ligjet e tjera i japin IKMT-së në formë statistikore bëhet me dije se për vitin 2015 janë realizuar:

1. Numri i inspektimeve të kryera → 7.625
2. Numri i masave administrative të marra → 257
3. Numri i çështjeve gjyqësore ndaj masave administrative → 111
4. Numri i masave administrative të shfuqizuara/ndryshuara nga vendimet gjyqësore → 47



6) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH), zhvillon aktivitetin e vet në bazë të Ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Kjo Drejtori, është në varësi të ministrisë që mbulon transportet. Bazuar në strukturën organizative të miratuar nga Kryeministria dhe Urdhrit të Ministrit nr. 154, datë 27.10.2010, “Rregullore e brendshme e funksionimit të DIH”, DIH ka për detyrë kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe garantimin e zbatimit të rregullave për:

- a) mbrojtjen, mirëmbajtjen, remontin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës hekurudhore;
- b) lëvizjen e sigurt të trenave;
- c) kontrollin teknik të mjeteve lëvizëse gjatë shfrytëzimit të tyre;
- ç) të gjitha procedurat e ndjekura gjatë pranimin për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore.

Nga kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2015 në të gjithë vijën hekurudhore specialistë dhe ndihmës inspektorë konstatojnë se gjendja teknike e vijës hekurudhore vazhdon të mbetet e dobët, pa shenja përmirësimi krahasuar me vitin 2014.

Kontrollet janë realizuar nga specialistë dhe ndihmës inspektorët e të dy sektorëve me një ritëm kontrolli pothuaj të njëjtë gjatë gjithë vitit, me një mesatare afërsisht 155 kontrolle në muaj. Gjatë

vitit 2015 nga inspektorët e sektorit teknik dhe sektorit të lëvizjes janë kryer gjithsej 1866 inspektime.

E rëndësishme për punën e DIH ka qënë evidentimi i pikave të dobëta të vijës hekurudhore, sidomos në:

- segmentet hekurudhore ku ka rrezik të rënies së inerteve mbi vijën hekurudhore nga shirat,
- rënia e gurëve nga skarpate,
- krijimi i rampave,
- bllokimi i tombinove,
- diletacioni, etj.

Gjatë vitit 2015 janë evidentuar 16 pika me rrezik për lëvizjen e trenave.

Në zonën malore Librazhd – Xhyrë, e cila është mjaft problematike, janë ushtruar kontrolle në pikat e rrezikshme të skarpateve malore për të evidentuar dhe parandaluar rënien e gurëve e dherave mbi trasenë e vijës hekurudhore. Në këtë zonë gjatë vitit 2015, ashtu si dhe në vitin 2014 nuk ka patur asnjë rast të bllokimit të perigonit nga moti i keq.

Aktualisht shpejtësia e lëvizjes së trenave vazhdon të jetë e kufizuar deri në 5 km/orë.

Gjatë këtij viti ka patur 3 raste të pezullimit të lëvizjes së trenave nga shkak i mbulimit të trasesë hekurudhore nga ujrat.

Kontrolli periodik vjetor i vijës hekurudhore për vitin 2015 është kryer nga grupet e kontrollit të përbashkëta të DIH dhe të Njesisë së Biznesit & Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore. Kontrolli është realizuar me këmbë në të gjithë veprat e artit dhe pikat e dobëta, ku rrezikohet lëvizja e trenave.

Në kontrollin periodik vjetor të vijës hekurudhore konstatohen, përveç atyre që kemi përmendur më lart, *mungesa në masë të treguesve të gurëve të hekto - kilometrazhit*, treguesit e fillimit e mbarimit të kthesave të vijës hekurudhore, tabela paralajmëruese pendencë të vijës, tabela sinjalizim kthese, etj., të cilat ndikojnë direkt në sigurimin e lëvizjes së trenave.

Gjatë vitit 2015 janë ushtruar kontrolle të vazhdueshme lidhur me gjendjen teknike të mjeteve hekurudhore. Janë ushtruar kontrolle në oficinën e riparimit të mjeteve hekurudhore për zbatimin e grafikut të riparimeve të lokomotivave, vagonave të udhëtarëve dhe të mallit, duke i kushtuar vëmendje cilësisë së riparimit të tyre.

Nga kontrollet e kryera për *gjendjen teknike të lokomotivave* rezultojnë se ato janë të rregullta për qarkullim. Sistemi i frenimit është efikas dhe aparatet e regjistrimit të shpejtësisë së lëvizjes së lokomotivave funksionojnë normalisht. Janë kontrolluar:

- në qarkullim aparatet dhe shiritat e regjistrimit të shpejtësisë në 108 trena malli e udhëtarësh. Pas kontrolleve janë bllokuar 8 lokomotiva për mos regjistrim të rregullt në shiritin e aparatit të matësit të shpejtësisë.

- shiritat e regjistrimit të shpejtësisë në 45 rastet e avarive e të aksidenteve hekurudhore të ndodhur gjatë vitit 2015. Nga kontrollet e kryera, në 6 raste ka patur tejkalim shpejtësie të lejuar të lëvizjes pa pasoja dhe në 2 raste me pasoja dhe fajësia ka qenë e mashinistit.

- kontrolluar lokomotivat për pastrimin nga mbeturinat e vajrave e karburantit të agregatëve xhenerikë e moto-elektrikë për të parandaluar rrezikun e rënies së zjarrit. Në vijim të kontrolleve është verifikuar kompletimi dhe funksionimi i fikseve të zjarrit që kanë në inventar lokomotivat, në disa raste ato janë provuar në vend për efikasitetin e tyre dhe aftësinë përdoruese të personelit të trenave.

Në kontrollet e ushtruara në trenat e udhëtarëve konstatohet se në përgjithësi gjendja teknike e tyre paraqitet e rregullt nga ana e sistemit të lëvizjes dhe atij të frenimit. Gjatë kontrolleve të ushtruara në stacionet e udhëtarëve dhe gjatë lëvizjes janë bllokuar për mangësi teknike kryesisht për mos rendiment frenimi 9 vagona udhëtarësh.

Trenat e udhëtarëve në ditë të zakonshme qarkullojnë me nga 2-3 vagona për arsye të uljes së numrit të udhëtarëve, kurse në ditët e festave e të fundjavës ky numër dyfishohet.

Me vëmendje janë kontrolluar punimet riparuese dhe shërbimet për të 15 vagonat e udhëtarëve të grumbulluar në stacionin hekurudhor Shkodër, për të qenë në gadishmëri për të transportuar pelegrinët në kishën e Shën Ndout me destinacion Shkodër – Laç e kthim, në periudhën Mars – Qershor. Këto shoqërohen vazhdimisht nga inspektorët e kontrollit, të cilët marrin pjesë edhe në kontrollin teknik të tyre para nisjes e gjatë udhëtimit.

Gjatë vitit 2015 është realizuar një volum transporti të trenave të mallit prej 197.772 ton e nga 300.000 ton të volumit të planifikuar. Ky volum transporti është rreth 140.514 ton më pak se transporti i realizuar në vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 janë kryer riparimet vjetore në vagonat tip vetëshkarkues, ku vëmendja nga ana e inspektorëve të sektorit teknik të Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor i është kushtuar rritjes së rendimentit të sistemit të frenimit të këtyre tipe vagonash.

Avaritë, aksidentet dhe incidentet e ndodhura në vijën hekurudhore gjatë vitit 2015

Të gjitha rastet e avarive, aksidenteve dhe incidenteve të ndodhura në vijën hekurudhore gjatë vitit 2015 janë evidentuar në mënyrë të detajuar për çdo rast në evidenca të veçanta. Në to përcaktohet data, vendndodhja, shkak, fajësia dhe pasojat. Këto të dhëna përcaktohen në bazë të këqyerjes së vendit të ngjarjes, pyetjes së personelit hekurudhor dhe konkluzioneve të analizave të kryera nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

Krahasuar me vitin 2014, gjatë vitit 2015 ka patur rritje të numrit të rasteve të ndodhura në vijën hekurudhore dhe konkretisht:

	Emërtimi	Viti		Diferenca
		2015	2014	
1	Avari në vijën hekurudhore	21	23	-2
2	Aksidente në vijën hekurudhore	25	8	+17

3	Incidente në vijën hekurudhore	13	10	+3
---	--------------------------------	----	----	----





Tabela me aksidentet në vijën hekurudhore gjatë vitit 2015

	Emërtimi i kalesave	Raste	Pasoja në njerëz		Dëmtim mjeti
			Vdekje	Plagosje	
	Kalesa të ruajtura	1	-	1	1
	Kalesa të paruaajtura	9	-	5	9
	Kalesa të paligjshme	15	3	8	8
	Shuma	25	3	14	18


Llojet e Aksidenteve për vitin 2015



Nga analizat e rasteve të avarive hekurudhore dhe të shkeljeve të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë dhe rregullave të sigurimit teknik, Komisioni i Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative, i ngritur pranë Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, për shkelje të rregullave ka marrë këto vendime:

- 2 masa ndëshkimore me heqje të “Dëshmisë së Aftësisë”;
- 3 masa ndëshkimore me “Gjobë” në lekë;
- 6 masa ndëshkimore “Paralajmërim”.

Masat Ndëshkimore për avaritë për vitin 2015



Gjatë vitit 2015, në zbatim të nenit 83, pika 2 të Kodit Hekurudhor numri i gjobave të vendosura në vend nga ana e inspektorëve gjatë ushtrimit të kontrolleve është 30 me vlerë 30.000 lekë.

7) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), zhvillon aktivitetin e vet sipas ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10217, datë 21.01.2010, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, si dhe VKM nr. 1576, datë 17.10.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka në përbërje të strukturës së saj Drejtorinë e Inspektimit Metrologjik, DIM, detyrat e së cilës përcaktohen në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2015 DIM ka ngritur grupe pune për inspektime që kanë pasur si objekt dhe konsistojnë në: mbështetje të aktivitetit të metrologëve, lidhur me subjektet që nuk kryejnë verifikimin e instrumentave matës; evidentimin dhe kontrollin e dokumentacionit metrologjik, që disponojnë këto subjekte; kontrollin vizual dhe teknik të instrumentave matës (pistoletave furnizuese të karburanteve dhe të gazit të lëngshëm, taksimetrave, masave volumore, peshoreve, produkteve të parapaketuara), dhe të shenjave metrologjike që kanë vendosur punonjësit e DPM-së; mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe të shtetit, si dhe parandalimin e shkeljeve të ndryshme nga subjektet që nuk veprojnë, në përputhje me ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar.

Drejtoria e Inspektimit Metrologjik gjatë vitit 2015, me grupet e saj të inspektimit, ka realizuar në total inspektime për 4101 subjekte.

DIM ka marrë pjesë në Task Forcën ndërinstitucionale me urdhër të Kryeministrit “Për koordinimin ndërinstitucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë” (urdhrit të DPM nr. 181, datë 04.05.2015), Urdhrit nr. 776, datë 27.01.2015 të Ministrit të MZHE-TS, “Për kontrollin e instrumentave matës”, në subjektet që tregtojnë me pakicë dhe shumicë hidrokarbure”.

Inspektorati Metrologjik ushtron kontroll në të gjithë vendin mbi realizimin e detyrave dhe planeve të inspektorëve, si dhe organizon me organet publike të mbrojtjes së konsumatorit kontrolle të përbashkëta. Inspektori kontrollon ligjshmërinë e instrumentit matës dhe urdhëron korrigjimin e parregullsive të vërejtura, marrjen e masave, si dhe ndalon përdorimin e instrumentave matës që nuk përputhen me kërkesat metrologjike. Inspektori kontrollon punën e një personi të autorizuar për kryerjen e verifikimeve metrologjike.

Gjatë vitit 2015 janë marrë masa administrative kundrejt 14 subjekteve të ndryshme, të cilat kanë patur në përdorim instrumenta matës në kundërshtim me rregullat dhe kërkesat metrologjike të ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar.


Në masat administrative të marra, arsyeja ka qenë kryesisht për mosverifikim të instrumentave matës, gjë që ka çuar dhe në bllokimin e këtyre instrumentave deri në kryerjen e procedurave të verifikimit metrologjik.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Drejtoria e Inspektimit Metrologjik synon rritjen e efikasitetit në përmbushje të kërkesave të konsumatorit mbi rezultatet e sakta të matjeve, si dhe kontrollin e instrumentave matës që hidhen në treg.

8) Ministria e Arsimit dhe Sportit

Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), gjatë vitit 2015 ka zhvilluar veprimtarinë duke u mbështetur në planin vjetor 2015 dhe në prioritetet e MAS-it. Kjo veprimtari ka qenë në funksion të misionit për rritjen e cilësisë së shërbimit në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimit të zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë. Për këtë ISHA ka kryer inspektimin, vlerësimin, këshillimin dhe nxjerrjen e përfundimeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe ka inspektuar nivelin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin e lartë.

ISHA gjatë vitit 2015, ka kryer **518** inspektime, përkatësisht: 18 inspektime të plota, 232 inspektime tematike, 90 inspektime të orientuara, si dhe 178 inspektime mbi bazë të ankimeve të ardhura në rrugë zyrtare.



Inspektimi në arsimin parauniversitar

Në bazë të planit vjetor janë kryer 18 inspektime të plota në institucionet e arsimit parauniversitar, si kopshte, shkolla 9-vjeçare, gjimnaze dhe shkolla profesionale, me një shpërndarje gjeografike të DAR/ZA-ve⁵ në të gjithë vendin.

⁵ DAR/ZA- Drejtori Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore.

Janë kryer 232 inspektime tematike (96 kopshteve dhe 38 shkolla) me fokus zbatimin e Dispozitave Normative 2013, për çështje si: drejtimi, administrimi e menaxhimi i këtyre institucioneve; kurrikula e zbatuar me elementët përbërës të saj; zbatimi i kodit të etikës së mësuesit; mjedisi psiko-social i të nxënësve.

Grupet inspektuese të ISHA-s, kanë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin shkollat ndaj rasteve të dhunës dhe parandalimin e tyre.

Janë zhvilluar 90 inspektime të orientuara për çështje si: planifikimi i punës për përgatitjen e nxënësve maturantë për provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2016; zbatimi i ligjshmërisë në shkollat jo publike; burimet njerëzore të DAR/ZA-ve.

Janë zhvilluar inspektime të orientuara për vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucionet arsimore private me kohë të pjesshme për procedurat e pranimit dhe plotësimin e dokumentacionit shkollor në përputhje me aktet ligjore. Inspektimi u krye lidhur me zbatimin e kriterëve të ligjshmërisë për plotësimin e dokumentacionit shkollor, regjistrimet dhe transferimet e nxënësve. Nga këto inspektime rezulton se në të gjitha shkollat e inspektuara, ka patur raste ku regjistrimi i nxënësve është kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Propozime për masë administrative për shkeljet e rënda të kërkesave ligjore të konstatuara në dokumentacionin shkollor (regjistra, amza, procesverbale të njëvlershmërisë së provimeve), të cilat përbëjnë mosplotësim të kushteve të licencimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit *i ka propozuar* Ministrin të Arsimit dhe Sportit heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë për 7 institucione jopublike.

Në kuadër të inspektimeve të orientuara, institucioni arsimor privat “Flabina”, i cili ka ndryshuar vendndodhjen pa marrë miratimin në MAS dhe ka ushtruar veprimtari të palicencuar në ciklin 9-vjeçar, ka marrë dënim “ndërprerje e menjëherëshme të aktivitetit në ciklin 9-vjeçar”.

Janë zhvilluar inspektime të orientuara për vlerësimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucioneve arsimore publike 9-vjeçare dhe të mesme, që mbulojnë fushën social-kulturore. ISHA inspektoi 17 shkolla social-kulturore, në të gjitha DAR/ZA-të e vendit.

Janë zhvilluar inspektime të orientuara të DAR/ZA-ve për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme për zbatimin e kriterëve të ligjshmërisë në veprimtarinë e 11 institucioneve arsimore jopublike 9-vjeçare dhe të mesme në DAR-et Tiranë, Tiranë Qark, Fier dhe Durrës.

ISHA ka kryer 178 inspektime mbi bazë ankimi të mbërritura në MAS ose drejtpërdrejtë nga mësues, drejtues shkolle, prindër, nxënës, DAR/ZA, ku për problemet e konstatuara ka dhënë rekomandime për zgjidhjen e ankimeve. Ndërsa, për shkeljet e konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar ka dhënë masa administrative të tilla si: këshillim, qortim, vërejtje, vërejtje me paralajmërim, si dhe gjobë me vlerë gjysmën e pagës mujore.

Inspektimi në arsimin e lartë

Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në Institucionet e Arsimit të Lartë.

ISHA ka punuar në përmbushje të objektivave dhe detyrave për inspektimin e zbatimit të kriterëve të legjislacionit, në institucionet e arsimit të lartë (IAL), duke i konsideruar ato si partnerë të rëndësishëm për arritjen e synimeve strategjike në fushën e arsimit.

ISHA ka ushtruar monitorime periodike dhe ka mbikëqyrur institucionet e arsimit të lartë edhe sa i përket cilësisë dhe kohës së zbatimit të legjislacionit.

Gjatë vitit 2015, ISHA ka realizuar 36 inspektime të orientuara në institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat.

Gjatë periudhës Mars-Prill 2015, me platformë të miratuar nga Kryeinspektori i ISHA-s, janë inspektuar lidhur me respektimin e procedurave ligjore për rekrutimet e stafit akademik 6 institucione të Arsimit të Lartë publik, si: Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti i Arteve, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, si dhe të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë privat (20 institucione).

ISHA gjatë vitit 2015, ka ndjekur rekomandimet e lëna për çdo Institucion të Arsimit të Lartë sipas konkluzioneve të arritura pas inspektimit të plotë në kuadrin e VKL-së së vitit 2014. Kështu në çdo institucion të inspektuar, është parë zbatimi i këtyre rekomandimeve dhe është ballafaquar puna e bërë me gjetjet e konstatuara para një viti.

Ankimime në portalin “Stop-korrupsioni”

Gjatë vitit 2015 ISHA ka kryer verifikimet për 74 raste të denoncimeve të depozituara në portalin “Stop-korrupsioni”, ku në fokus kanë qenë përgjithësisht probleme lidhur me marrëdhëniet nepotike në rekrutimin e stafit akademik apo administrativ në IAL-të publike, denoncime për mitmarrje nga ana e pedagogëve, marrëdhëniet pedagogë-studentë etj.

Në këtë kuadër, në përgjigje të denoncimeve janë analizuar rastet në IAL-të përkatëse, është kontrolluar dokumentacioni, infrastruktura, rekrutimi i stafit akademik dhe administrativ, frekuentimi i procesit akademik, kontratat me studentët, marrëdhëniet pedagogë-studentë, mjediset mësimore, etj.

Ankimime

ISHA ka kryer 6 verifikime për ankimime lidhur me shkeljet në zbatimin e ligjshmërisë nga ana e IAL-ve, ku ka dhënë rekomandime për marrjen e masave për ndalimin e praktikave të shkeljeve dhe rekomandime për draftimin e akteve për parandalimin e shkeljeve e përmirësimin e gjendjes.

Me Urdhër të MAS-it janë realizuar 3 inspektime me objekt verifikimin e përputhshmërisë së infrastrukturës mësimore të institucioneve të arsimit të lartë privat, si dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

Gjithashtu, me Urdhër të MAS-it, u monitorua procesi i intervistimit të kandidatëve, si dhe u krye monitorimi për vlerësimin e procedurave të pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve, në specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016.

Zgjidhja e ankimimeve përmes inspektimeve

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka shqyrtuar 98 ankimime të ardhura nga mësues, drejtues shkolle, prindër, nxënës dhe DAR/ZA, nga të cilat 37 raste janë zgjidhur nëpërmjet inspektimeve në terren dhe 61 raste nëpërmjet komunikimit me DAR/ZA-të. ISHA ka trajtuar 39 raste të ankimimit nëpërmjet komunikimit zyrtar me DAR/ZA-të ose shkollat përkatëse në: DAR-et Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Vlorë, Kukës, Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Fier dhe ZA Lushnjë, Bulqizë, Tropojë, Mirditë, Kurbin, Kavajë, Mallakastër, Përmet, Peqin, Kuçovë, Kolonjë, Gramsh dhe Tepelenë.

Objekti kryesor i ankimimeve ka qenë verifikimi i problemeve të ngritura në letrat ankimuese drejtuar MAS-it dhe ISHA.

9) Ministria e Kulturës


Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA) ushtron veprimtarinë dhe kompetencat e saj në bazë të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 232, 19.04.2006, “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit” (ZSHDA). ZSHDA kryen mbikëqyrjen e tregut nëpërmjet inspektimit dhe marrjes së masave administrative për subjektet që nuk kanë përmbushur detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.04.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2015, ZSHDA ka kryer gjithsej në veprimtarinë e saj **1073** inspektimet dhe monitorime në Republikën e Shqipërisë. Inspektime janë bërë edhe në subjekte përdorues të veprave letrare, artistike apo shkencore, duke i informuar dhe duke lënë detyra dhe afate për përmbushjen e tyre. Aty ku janë konstatuar shkelje të ligjit shqiptar për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, është proceduar me vendosjen e masave administrative (gjobë).


Në kategorinë e subjekteve të inspektuara janë: OSHMA (televizione valore, televizione kabllorë, radio, IPTV), call center, fotokopje, bar kafe, restorante, hotele, videoteka, shtëpi diskografike, librari, tregti karburanti.

Inspektimet e realizuara janë kryer në zonat e inspektimit me shtrirje si në vijim:

INSPEKTIMET SIPAS ZONAVE



Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015 janë marrë **218** masa administrative sipas kategorive të subjekteve si në vijim:

MASA ADMINISTRATIVE
GJATË VITIT 2015

Gjithashtu, gjatë vitit 2015 ndaj ZSHDA janë zhvilluar **147** procedime administrative, nga të cilat:

- ✚ 2 procedime administrative kanë përfunduar në favor të palës ankimuese;
- ✚ 4 procedime administrative janë braktisur nga pala kërkuuese;

- ✚ 31 procedime administrative janë pezulluar me kërkesë të palës kërkuese;
- ✚ 42 procedime administrative janë duke u shqyrtuar;
- ✚ 24 procedime administrative kanë përfunduar duke u zgjidhur me mirëkuptim midis palëve;
- ✚ 44 procedime administrative janë pushuar pasi janë gjetur mangësi.

Problematikat e hasura

Në kuadër të inspektimeve lidhur me kategorinë e përdoruesve të veprave shkencore (programet kompjuterike), institucioni është ndeshur me një seri problemesh lidhur me trajtimin e pjesës së licencimit të sistemeve operative, pasi pjesa më e madhe e kompjuterëve që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë kompjutera të përdorur, me një pullë ekzistuese (OEM) dhe gjatë inspektimeve inspektorët janë ndeshur me problematikën specifike se si duhej trajtuar, si një sistem i licencuar apo si një sistem i palicencuar.

Në sajë të punës që institucioni bëri për një zgjidhje sa më të shpejtë të këtij ngërçi, në bashkëpunim dhe me Microsoft u arrit që për herë të parë në vendin tonë të licencohej një operator për tregtimin e licencave Refurbished, kjo pasi këto kompjutera hyjnë pa asnjë lloj sistemi dhe kanë nevojë për licencim.

Përsa i përket pjesës së librit, edhe këtu është hasur një problematikë në kuadër të inspektimeve që janë kryer si në librari, në pika fotokopjimi dhe shtëpi botuese, ku më kryesorja është pjesa e respektimit të elementeve të botimit të një vepre si: çmim, tirazh, shtëpi botuese, etj., elemente të cilët duhet të vendosen nga ana e botuesit, ashtu si dhe pjesa e respektimit të kontratës së botimit midis shtëpisë botuese dhe autorit.

10) Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në fushën e juridiksionit që mbulon, përfshin Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe Repartin Inspektim Shpëtim Miniera.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), zhvillon aktivitetin e vet sipas VKM nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial” dhe ligje të tjera specifike, si dhe përfshin këto funksione inspektimi:

- a) Inspektimin e pajisjeve dhe instalimeve elektrike
- b) Inspektimi i naftës e gazit
- c) Inspektimin e pajisjeve nën presion

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjatë vitit 2015, ka kryer veprimtarinë e inspektimit, sipas këtyre funksioneve, si më poshtë:

a) Inspektimin e pajisjeve dhe instalimeve elektrike


Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (DIPIE). DIPIE mbikëqyr sigurinë elektrike, e cila përfshin kryesisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në faktorët përbërës të tij si: sigurisë së punës së

impianteve, pajisjeve dhe instalimeve elektrike; përmirësim i procedurave të punës dhe të punimeve riparuese, si dhe rritje të shkallës së njohurive tekniko-profesionale të punonjësve që mirëmbajnë impiante, pajisje dhe instalimeve elektrike.

Në bazë të programit vjetor të punës, DIPIE ka kryer **702** inspektime teknike sipas rëndësisë së pjesës së rrjetit që kontrollohet, nivelit të tensionit, rrezikshmërisë që paraqet, afateve të kontrollit etj. Në këtë periudhë kanë ndodhur 22 aksidente, të cilat kanë ardhur në rënje krahasuar me periudhën paraardhëse. Për trajtimin e aksidenteve, është vepruar sipas një procedure shumëvjeçare duke përgatitur dosje të ekspertimit teknik me masat administrative përkatëse sipas përgjegjësisë (gjobë, propozim për largim nga puna ose ndjekje penale) dhe marrjen e masave parandaluese.

b) Inspektimi i naftës dhe gazit

Inspektimi i naftës dhe gazit që kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe të Gazit (DING). DING monitoron respektimin e standardeve të cilësisë së naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nga subjekte të tregtimit me shumicë e pakicë para zhdoganimit, në impiantet e prodhimit dhe instalimet e tregtimit për të shmangur abuzimet dhe falsifikimet. Në bazë të programit vjetor të punës DING ka kryer **7922** inspektime të subjekteve, ku përfshihen inspektime për cilësi, teknike, dokumentacioni dhe rastet e bllokimit. Duhet theksuar, në lidhje me Vërtetimet Teknike, se në muajin Mars 2015 doli Urdhëri i ri i Ministrit nr. 76, datë 18.03.2015 me kërkesat e reja ku përfshihej dhe Polica e Sigurimit për palët e treta, kërkesë e cila hasi dhe në reagime nga subjektet në fazën fillestare të zbatimit të tij, duke ulur kështu numrin e këtyre inspektimeve krahasuar me vitin parardhës.




Nga 6041 mostra të marra gjatë inspektimeve, 271 prej tyre kanë rezultuar jashtë normave teknike të lejuara. Për shkelje të dispozitave ligjore në ushtrimin e aktivitetit dhe për mosrespektim të normave dhe kushteve teknike dhe atyre të cilësisë, janë marrë masa ndëshkimore administrative

sipas përcaktimeve të ligjit. Kështu, gjatë vitit 2015, janë marrë 296 vendime gjobe dhe 63 revokime licencash.

c) Inspektimin e pajisjeve nën presion

Inspektimi i pajisjeve nën presion kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP), e cila bën evidentimin dhe inventarizimin e pajisjeve nën presion, inspektimin e subjekteve dhe pajisjeve nën presion për respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullave teknike në fuqi për futjen në treg të pajisjeve nën presion, si dhe kryerjen e inspektimit teknik periodik të detyrueshme për pajisjet nën presion nëpërmjet Trupave Inspektuese Palë e Tretë apo Organeve të Vlerësimit të Konformitetit.

Gjatë vitit 2015 janë kryer **1440** inspektime në subjekte, **3260** inspektime për pajisje nën presion, si dhe janë bërë 440 regjistrime të pajisjeve nën presion. Pas inspektimeve të kryera janë plotësuar 1661 Akt-Inspektime, janë mbajtur 21 Akt-Konstatime, si dhe janë lëshuar 113 Urdhër-Ndalesa për pajisje të ndryshme nën presion.



Nga inspektimet e ushtruara në subjektet shtetërore dhe private është konstatuar se ka punonjës si kaldaist dhe përdorues të pajisjeve nën presion, të cilët nuk kanë qenë të pajisur me dëshmitë përkatëse të aftësisë. Si rezultat, gjatë vitit 2015 janë lëshuar 39 dëshmi aftësie të ndarë në 24 për përdorues të pajisjeve nën presion dhe 15 për përdorues të kaldaive të avullit.

Objekt i aktivitetit inspektues të inspektorëve është edhe kontrolli i dokumentacionit teknik të instalimit të pajisjeve nën presion, si dhe skema apo projekti teknologjik i këtyre instalimeve. Gjatë vitit 2015 janë miratuar 91 projekte teknologjike, të cilat u përkasin subjekteve që tregtojnë me pakicë dhe shumicë Gaz të Lëngëzuar të Naftës (GLN). Gjithashtu, gjatë vitit 2015 janë lëshuar 13 Çertifikata për automjetet që transportojnë bombola me GLN.

Përveç inspektimeve të kryera në përmbushje të planit vjetor, ISHTI ka kryer inspektime edhe në kuadër të task forcës së ngritur nga Kryeministri në kuadër të luftës kundër informalitetit në ekonomi.

Më poshtë gjendet të dhënat përmbledhëse lidhur me inspektimet e realizuara nga grupet e punës së ISHTI, DPD, DPT dhe DPPSH mbi cilësinë dhe problematikat e tjera përsa i përket tregut të karburantit në Republikën e Shqipërisë.

- Nr. i subjekteve. të kontrolluara	800
- Nr. i mostrave të marra në total	1634
- Nr. i mostrave të marra për gazin	891
- Nr. i mostrave të marra për benzinën	734
- Nr. i mostrave të tjera	9
- Nr. i mostrave të marra për gazoil me shmangie cilësie	64
- Nr. i mostrave të marra për benzinë me shmangie cilësie	8
- Akt konstatime për cilësi	66
- Akt konstatimi për dokumentacion	13
- Akt bllokimi	9
- % e shmangieve nga standardi	4.4%

Në kuadër të task forcës së ngritur nga institucioni i Prefektit, me Udhrin nr. 160, datë 14.08.2015, të Prefektit të Tiranës, u kryen inspektime me Task Forcën e përbërë nga PMNZSH e Tiranës, ISHTI, Krimi Ekonomik, Tatim Taksa dhe Zyra e Punës. **U inspektuan 48 subjekte dhe nga ana e ISHTI u mbajtën 12 Akt Konstatime dhe 7 Akt Bllokime.** Duhet theksuar se, ISHTI-it mbajti qëndrim administrativ vetëm për subjektet të cilat ishin të regjistruara (me NIPT) siç e parashikon dhe ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar. Subjektet të cilat nuk kishin asnjë lloj dokumentacioni kaluan në shqyrtim nga Krimi Ekonomik.


Reparti Inspektim Shpëtim Miniera (RISHM)

Reparti Inspektim Shpëtim Miniera vepron në bazë të ligjit nr. 8741 datë 15.02.2001, “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Veprimtaria e drejtorisë së inspektimit për vitin 2015, si njësi përgjegjëse në RISHM është përqendruar në realizimin e kontroleve teknike në miniera, në vlerësimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

Gjatë vitit 2015 janë kryer **576** inspektime në subjekte minerare. Nga këto 314 nuk kryenin aktivitet në momentin e kontrollit, ndërsa në 262 subjekte kontrollet e realizuara janë të pasqyruara me akte inspektimi. Përkatësisht:

➤ 28 subjekte janë kontrolluar (inspektuar) nga 3 herë	= 84
➤ 77 subjekte janë kontrolluar (inspektuar) nga 2 herë	= 154
➤ 164 subjekte janë kontrolluar (inspektuar) nga 1 herë	= 164
➤ 6 Fabrika pasurimi	= 6

- 4 HEC-e = 4
- Inspektime të posaçme = 54



Subjekte të gjendura në kushte pune janë **262 subjekte**, nga këto:

1. Subjekte nëntokësore = **141**
2. Subjekte sipërfaqësore = **121**

Në përfundim të inspektimeve për subjektet që kanë patur shkelje janë marrë masa administrative ndaj drejtuesve teknikë dhe administratorëve. Këto masa kanë qenë:

- 36 Akt-Ndalesa, nga të cilat 19 në objekte nëntokësore dhe 17 në objekte sipërfaqësore.
- 18 Gjoba

Gjatë vitit 2015 ka patur 11 raste aksidentesh fatale me humbjen e 12 jetëve në objektet minerare të vendit, ku 10 raste kanë qenë në objekte nëntokësore dhe 1 rast në sipërfaqe. Për të gjitha ngjarjet është bërë analizë e plotë mbi shkaqet që kanë sjellë këto aksidente. Pas çdo analize janë marrë masa konkrete për personat përgjegjës, si dhe masa teknike e organizative për përmirësimin e gjendjes. Masat ndaj personave përgjegjës kanë qenë që nga kallzimet penale, propozime për revokim leje, gjoba ndaj drejtuesve dhe largime apo shkarkime nga pozicionet e punës.

Prioritet në punën inspektuese të RISHM gjatë vitit 2015, ka qenë siguri i zbatimit të dispozitave ligjore e akteve nënligjore për sigurinë në punë, si dhe mbikqyrja nëpërmjet inspektimeve periodike e të posaçme për zbatimin e rregullave të teknikës së sigurimit për të garantuar një rregjim normal pune e parandalim të rreziqeve në veprimtaritë minerare. Për realizimin e këtij qëllimi, u kërkua dhe për herë të parë u arrit të realizohej norma e kontrolleve teknike në miniera

nëntokësore e sipërfaqësore, fabrika pasurimi dhe impiantet e përpunimit të mineraleve sipas akteve ligjore.

Çdo objekt mineral me rregjim gazi u inspektua 3 herë në vit; çdo objekt nëntokësor u inspektua 2 herë në vit dhe objektet sipërfaqësore 1 herë, gjatë vitit 2015. Janë realizuar nga 3 inspektime për çdo subjekt mineral të zonës D, Bulqizë; me qëllimin e mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm të gjendjes teknike të punimeve minerare të kësaj zone problematike. RISHM realizoi me sukses mbylljen e 67 grykave të punimeve minerare në minierat e braktisura të rretheve Pogradec, Korçë, Librazhd dhe Tiranë.

Drejtoria e inspektimit ka realizuar me sukses dhe në afat kohor të shkurtër të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në rregulloren e brendshme të RISHM-it apo në aktet ligjore e nënligjore. Kështu ka funksionuar komisioni i vlerësimit të projekteve teknike për depot e lëndëve plasëse dhe i subjekteve që kërkojnë të pajisen me autorizimin për përdorimit civil të lëndëve plasëse. Gjatë vitit 2015, nga drejtoria e inspektimit janë kryer 27 verifikime për vend ndërtimet dhe miratimet e projekteve të ndërtimit të depove për magazinimin e ruajtjen dhe lëndëve plasëse. Janë vlerësuar teknikisht 55 projekte teknike të subjekteve që kanë kërkuar të pajisen me autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse.

Gjithashtu, janë realizuar 44 analiza të matjes së rezistencës në tërheqje të litarëve të çelikut; janë testuar dhe pajisur me dëshmi 187 zjarrmëtarë; si dhe janë rregjistruar 68 subjekte minerare.

Megjithë punën e mirë të bërë gjatë kësaj periudhe nga Drejtoria e Inspektimit, duhet tërhequr vëmendja përse i përket ndëshkimeve administrative ndaj subjekteve që konstatohen me shkelje. Vihet re një frymë tolerante e pa justifikuar, gjë e cila duhet të evitohen gjatë inspektimeve të vitit të ardhshëm.

Në përpjekje për realizimin e detyrave funksionale, duke vlerësuar dobësitë dhe vështirësitë që janë hasur, vlen të përmendet nevoja për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e Minierave në Ministri dhe AKBN për një evidentim më të saktë dhe të përditësuar periodikisht të lejeve minerare dhe koncesioneve të dhëna të HEC-ve, si dhe bashkerendimin e veprimeve në rastet e kontrolleve për problematika të veçanta.

Disa nga problemet e hasura nëpër subjekte të ndryshme kanë qenë:

Mungesa e drejtuesve teknikë në subjektet që kryejnë veprimtari minerare, duke sjellë një vakum për personel të specializuar e çertifikuar për drejtimin teknik të aktivitetit të tyre.

Problemi i vjeljes së gjobave. Procedurat administrative për rinovimin e lejeve minerare duhet të përmirësohen, ku të kushtëzohet aprovimi i rinovimit të lejeve minerare, me shlyerjen e detyrimeve (gjobave) ndaj RISHM-it.

V. KOMENTE

Nga Raporti i vitit 2015, del qartë se inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, gjatë këtij viti, filluan të zbatojnë parimet e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektoratet shtetërore kanë përshtatur procedurën e inspektimit dhe dokumentet e inspektimit që ato përdorin me procedurën dhe dokumentet unike të inspektimit të miratuara nga Inspektorati Qendror.

Në përgjithësi inspektoratet shtetërore ende nuk kryejnë programimin e veprimtarisë së tyre inspektuese, vjetor e mujor, në bazë të metodologjisë së vlerësimit të riskut. Në lidhje me procedurat, dokumentet e inspektimit, si dhe programin mbi bazë risku, në tetë inspektoratet shtetërore që janë mbikëqyrur nga Inspektorati Qendror, u vërejtën mangësi për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse. Plotësimi i këtyre rekomandimeve do të jetë objekt i mbikëqyrjes nga Inspektorati Qendror edhe në të ardhmen, në mënyrë që të avancohet në lidhje me këto veprimtari të inspektorateve shtetërore.

Gjithashtu, objekt i mbikëqyrjes së Inspektoratit Qendror kanë qenë edhe procesi i ankimit për masat administrative të marra nga inspektoratet shtetërore dhe apelimit të këtyre masave administrative, si dhe mënyra e mbledhjes së gjobave. Jo të gjithë Inspektoratet shtetërore kanë dhënë informacione të qarta në lidhje me buxhetet e tyre, për të cilat është kërkuar që të jenë pjesë e raportimeve vjetore. Për më tepër vërehet se, megjithëse është dërguar një model unik raportimi, raportet e inspektorateve shtetërore nuk paraqiten sipas këtij formati.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së inspektorateve, është vënë re se ka edhe mbivendosje të ligjeve sektoriale. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor vë në dukje këtë mbivendosje të ligjeve sektoriale, që krijojnë problematikë dhe ngarkesë për subjektet, si rrjedhojë e inspektimit të dyfishtë. Ligjet sektoriale që kanë mbivendosje janë ligji nr. 8025, datë 09.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, dhe përplasja në këtë rast ndodh me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet, të cilët kanë në funksion si liçensimin, ashtu edhe inspektimin e subjekteve, ndërkohë që pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ka inspektorë të kualifikuar në fushën e rrezatimit që mund të merren me procesin e inspektimit të kësaj fushe.

Konstatohet se, gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të inspektorëve shtetërorë, të cilët janë trajnuar për zbatimin e parimeve të ligjit të ri të inspektimit, si dhe me procedurat e dokumentet e reja të inspektimit. Trajnimi i kryer, nuk është shoqëruar me pajisjen e tyre me certifikatë për shkak të një ngërçi ligjor. Gjithashtu, Inspektorati Qendror vazhdon procesin e pajisjes së inspektorëve shtetërorë me kartë inspektori.

VI. PRAKTIKAT E MIRA

Gjatë shqyrtimit të raporteve vjetore të paraqitura nga Inspektoratet shtetërore, dhe nga analiza e veprimtarisë së Inspektoratit Qendror, në praktikat e mira mund të përmendet bashkëpunimi i mirë ndërmjet inspektorateve shtetërore të cilat ishin ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Bashkërendimi i inspektimeve të përbashkëta ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, mundësoi zbatimin me efektivitet i këtij ligji nga këto inspektorate shtetërore.

Gjithashtu, në kuadër të aksionit kundër informalitetit në ekonomi të drejtuar nga Drejtoria e Tatim Taksave dhe të koordinuar nga Inspektorati Qendror, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit bashkëpunuan në këtë aksion të suksesshëm për një periudhë kohore katër mujore, Shtator – Dhjetor 2015.

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

Në kuadër të përmbushjes së gjithë aktivitetit të Inspektoratit Qendror, buxheti i institucionit është shpenzuar për kryerjen e detyrave funksionale të këtij institucioni. Plani i buxhetit të vitit 2015, i miratuar nga Ministria e Financave, për Inspektoratin Qendror, ka qenë 69,170,000 lekë në total dhe i detajuar sipas zërave më poshtë:

000 / lekë

BUXHETI I VITIT 2015					
Nr..	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Plani 2015	Fakti 2015	Diferenca Plan/Fakt	Realizimi i buxheti në %
1	Paga, shpenzime të tjera personeli	19,100	18,529	571	97%
2	Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	3,470	2,853	617	82.2%
3	Mallra, shërbime dhe shpenzime të tjera operative	11,600	9,259	2,341	79.8%
4	Investime	35,000	9,582	25,418	27.4%
	T O T A L I	69,170	40,223	28,947	58.1%

Buxheti vjetor u realizua sipas akteve ligjore ekonomiko-financiare në fuqi për të gjitha zërat e tij.

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë vlera e investimeve, e cila ka një peshë specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve buxhetore, ndërsa fondi i pagave me kontributin e sigurimeve në vlerë absolute është më i vogël.

Zëri i buxhetit 231 “Investime”, i cili ishte me një vlerë totale prej 35,000,000 lekë, u realizua në masën 27.4 %. Mosrealizimi i investimeve, ka ardhur si rezultat i anulimit të procedurave të prokurimeve publike me tender të përqendruar nga Ministria e Punëve të Brendshme për Blerje Pajisje Hardware (kite portabël) për fuqizimin e Portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”. Gjithashtu, për të gjitha procedurat e prokurimit është zbatuar Ligji i Prokurimit Publik.

I gjithë buxheti i miratuar për vitin 2015 u realizua në masën 58.1 % të fondit të miratuar për t’u shpenzuar për këtë periudhë.

Inspektorati Qendror, për vitin 2016 ka hartuar një buxhet realist, i cili do të lejojë të kryejë në kohë të gjitha aktivitetet e planifikuara, për përmbushjen e misionit të tij.

IX. KONKLUSIONE

Ecuria e reformës në inspektime ka sjellë përmbushjen e disave nga objektivat kryesore të saj. Unifikimi i procedurave të inspektimit, dokumentacionit përkatës dhe zhvillimi i një modeli online të inspektimeve, kanë rritur në mënyrë të dukshme efektivitetin dhe cilësinë e veprimtarisë inspektuese, si në ato inspektorate shtetërore të cilat kanë përfunduar ristrukturimin sipas ligjit të inspektimeve ashtu edhe në ato të cilat nuk kanë përfunduar ende procesin e ristrukturimit. Inspektorati Qendror ka bashkërenduar sistemin e inspektimeve për organizimin edhe të inspektimeve të përbashkëta, si dhe ka zhvilluar takime për të nxitur dhe organizuar inspektime të përbashkëta në terren. Një bashkëpunim i inicuar nga Inspektorati Qendror ka qenë në kuadër të organizimit të punës së përbashkët për zbatimin e ligjit antiduhan, ku inspektoratet shtetërore përkatëse u koordinuan nën udhëheqjen e Inspektoratit Qendror dhe përcaktuan planin e masave, i cili u zbatua me korrektësi.

Arritje të dukshme ka pasur në drejtim të programimit të veprimtarisë inspektuese mbi bazë të vlerësimit të riskut, si dhe vlerësimit të inspektorateve shtetërore mbi bazë performance. Në lidhje me programimin mbi bazë risku, Inspektorati Qendror intensifikoi punën për përpunimin e një metodologjie të avancuar për llogaritjen e saktë të riskut të subjekteve, i cili do të shërbejë për të përqendruar kapacitete inspektuese në ato subjete ku identifikohet rreziku më i madh për sigurinë publike. Ndërsa, pas miratimit nga Inspektorati Qendror të metodologjisë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së punës së inspektorateve shtetërore, këto të fundit nuk kanë hartuar treguesit e tyre të performancës, dhe nuk kanë kryer vlerësime të punës së tyre mbi bazë të treguesve të miratuar më parë, me përjashtim të ISHMP.

Inspektorati Qendror, në lidhje me kapacitetet njerëzore të inspektorateve shtetërore të cilat mbeten ende të dobëta, hartoi dhe zbatoi gjatë vitit 2015 një plan trajnimi për të gjitha inspektoratet shtetërore ku u identifikuan nevoja për trajnimin e stafit, për rreth 340 inspektorë, për shkak të rekrutimit të stafit të ri në inspektoratet shtetërore apo të ristrukturimit të tyre. Trajnime të inspektorëve shtetërorë u realizuan edhe për përdorimin e portalit unik “e-Inspektimi”, përdorimi masiv i të cilit do të rrisë transparencën e inspektimeve dhe do reduktojë kohën e inspektimit në subjekte.

Gjithashtu, Inspektorati Qendror ka pajisur me karta inspektori shtetëror rreth 1000 inspektorët shtetërorë në detyrë në mënyrë që të identifikohen me korrektësi inspektorët shtetërorë të cilët kanë të drejtë për të kryer procedurën e inspektimit, për të evituar inspektimet e paligjshme të personave jashtë inspektorateve shtetërore. Inspektorati Qendror ka kryer përditësimin e Regjistrit Kombëtar të inspektorëve në detyrë, të cilët kanë të drejtë të kryejnë procedurë inspektimi në mënyrë që të mbështesin një proces sa më transparent inspektimi.

Portali unik “e-Inspektimi” nuk ka funksionuar për të gjitha inspektoratet shtetërore të cilat kanë kryer trajnimet e inspektorëve të tyre shtetërorë dhe janë pajisur me paketa inspektimi, për shkak

se vetë këto inspektorate shtetërore nuk e kanë përdorur plotësisht këtë Portal. Inspektoratet shtetërore të cilat janë pajisur me të gjitha mjetet logjistike dhe burime njerëzore duhet të vënë në funksionim procedurat e inspektimit elektronik nëpërmjet Portalit unik “e-Inspektimi”. Megjithatë, kapacitetet njerëzore janë ende të dobëta, gjë e cila është edhe një nga arsyet e mosfunksionimit të plotë të ligjit të inspektimit. Inspektorati Qendror po punon për hartimin dhe zbatimin e procedurave të trajnimit dhe çertifikimit të inspektorëve shtetërorë.

Inspektorati Qendror kërkohet të instensifikojë përpjekjet për të rritur rolin e vet koordinues dhe mbikëqyrës të veprimtarive të inspektimit, për të rritur sigurinë e zbatimit të ligjit të inspektimit dhe ligjeve sektorale nga ana e inspektorateve shtetërore.

Për vitin 2016 sfidë mbetet kryerja e inspektimeve on-line nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”, për katër Inspektoratet shtetërore të cilat janë pajisur me të gjithë infrastrukturën e domosdoshme për përdorimin e Portalit “e-Inspektimi”. Nga ana e Inspektoratit Qendror kërkohet të vazhdojë projekti për pajisjen e inspektorateve shtetërore me kite portabël inspektimi.

VIII. REKOMANDIME

Inspektorati Qendror, mbi bazën e analizës së kryer mbi aktivitetin e Inspektorateve Shtetërore/trupa të tjera inspektuese për vitin 2015, si dhe aktivitetit mbikëqyrës së veprimtarisë së tyre gjatë kësaj periudhe, rekomandon si më poshtë:

- Të përfundojë riorganizimi i atyre inspektorateve shtetërore të cilat ende nuk janë të krijuara në përputhje me ligjin e inspektimit, si dhe të hartohen deklarata të qarta që përshkruajnë misionin e secilës prej tyre, me objektiva konkrete për mbrojtjen e interesit publik sipas fushave që ato mbulojnë, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së konsumatorëve.
- Legjislacioni themelor, manualët dhe rregulloret teknike të çdo inspektorati shtetëror duhet të jenë koherente dhe të evidentojnë ndryshimet e bëra çdo vit në drejtim të veprimtarisë inspektuese. Ky legjislacion kërkohet të marrë mendim këshillimor nga Inspektorati Qendror para miratimit të tyre, gjë e cila deri tani është bërë në pak raste. Përafrimi i legjislacionit të fushave të ndryshme të inspektimit me *acqui communautaire* lipset për fuqizimin e mbrojtjes së interesit publik nëpërmjet veprimtarisë së këtyre inspektorateve.
- Vlerësimi i punës së inspektorateve shtetërore në vazhdim kërkohet të bëhet sipas treguesve dhe metodologjisë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së punës së inspektorateve shtetërore të unifikuara nga Inspektorati Qendror. Këto të fundit nuk kanë hartuar treguesit e tyre të performancës, dhe nuk kanë kryer vlerësime të punës së tyre mbi bazë të treguesve të miratuar më parë.
- Të zbatohet me përpikmëri procedura e unifikuar dhe dokumentet e inspektimit, si dhe të bëhet plotësimi i saktë i bazës ligjore në të gjitha dokumentet e përdorura gjatë procesit të veprimtarisë inspektuese, nga të gjitha inspektoratet shtetërore, pasi nga mbikëqyrja e veprimtarisë së tyre inspektuese nga ana e Inspektoratit Qendror janë vërejtur devijime për

të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse. Të zbatohen rregullat e programimit të veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut të miratuar nga Inspektorati Qendror, pasi të jenë përshtatur dhe plotësuar të dhënat në Portal për funksionet e inspektimit që mbulojnë. Inspektoratet shtetërore të krijojnë dhe mbajnë regjistrin e gjobave deri në ekzekutimin e tyre.

- Të zgjerohet fokusi i ndërveprimit midis inspektorateve shtetërore e të përfshijnë inspektime të përbashkëta me qëllim parandalimin e moszbatimit të kërkesave ligjore, sipas eksperiencës së krijuar për inspektimin e ligjit antiduhan. Kërkohet që organizimi i inspektimeve të përbashkëta nga ana e inspektorateve shtetërore, nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, të bëhet pjesë e veprimtarisë normale të këtyre institucioneve, për të zvogëluar barrën ndaj subjekteve të inspektimit.
- Inspektoratet shtetërore të hartojnë programet e inspektimit bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe t'i miratojnë nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të paraqesin programet e tyre mujore të inspektimit sipas përcaktimeve ligjore.
- Inspektoratet shtetërore të krijojnë “Organin epror”, pra Komisionin e ankimimit sipas ligjit për inspektimin, sipas procedurës së unifikuar të përgatitur nga Inspektorati Qendror.
- Inspektoratet shtetërore duhet të hartojnë statistika të sakta dhe përmbledhëse, për të mundësuar analiza të qëndrueshme për të bërë përmirësimet e duhura. Të publikojnë të dhënat e veprimtarisë së tyre për të rritur transparencën ndaj publikut.
- Të ushtrohet mbikëqyrje efektive mbi aktivitetin e inspektimeve për të rritur përgjegjshmërinë në punë të inspektorëve. Inspektoratet shtetërore kërkohet të përdorin procedurat online të inspektimit dhe monitorimit të aktivitetit të tyre.
- Inspektoratet shtetërore të përdorin Linjë telefonike falas për bizneset dhe qytetarët në lidhje me ankesat, për të përmirësuar veprimtarinë e tyre në lidhje me minimizimin e veprimeve korruptive në fushat e inspektimit që ato mbulojnë. Për rastet e ankesave të ketë procedura të sakta dhe transparente të ndjekjes së tyre.
- Informimi i subjekteve të inspektimit dhe publikut duhet të përmirësohet më tej në mënyrë që subjektet e inspektimit që operojnë në Shqipëri dhe publiku të njohin të drejtat dhe detyrat e tyre. Website të përditësuara të Inspektorateve shtetërore, të publikojnë broshurë inspektimi për subjektet me procedurat e inspektimit dhe informacione të tjera të vlefshme për një partneritet më të mirë me subjektet.
- Të fuqizohet roli i Inspektoratit Qendror në sistemin e inspektimit me detyra dhe funksione të tjera për rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

X. ANEKSE**ANEKSI I: Akte nënligjore të miratuara gjatë vitit 2015 nga Inspektorati Qendror.**

Nr.	Baza ligjore (ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e miratimit
1.	neni 16, pika 2, germa c; neni 28, pika 4	Urdhër nr. 58/1, datë 22.01.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014, “Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë”	22.01.2015
2.	neni 16, pika 2, germa c; VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”	Urdhër nr. 5, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”	19.02.2015
3.	neni 16, pika 2, germa c; VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”	Urdhër nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”	19.02.2015
4.	neni 16, pika 2, germa ç; VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave	Urdhër nr. 7, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe	19.02.2015

	të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”	cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit e raportimit të tyre”	
5.	Ligji 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”	Urdhër nr. 12, datë 10.04.2015, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit në Inspektoratin Qendror”	10.04.2015
6.	neni 16	Urdhër nr. 13, datë 23.04.2015, “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”	23.04.2015
7.	neni 16, pika 5; VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”	Urdhër nr. 15, datë 07.05.2015, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”	07.05.2015

ANEKSI II: Ligje sektorale të miratuara gjatë vitit 2015.

Nr.	Emërtimi i aktit ligjor	Data e miratimit
1.	VKM Nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”	14.01.2015
2.	Ligji Nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar (IKMT)	16.01.2015
3.	VKM nr. 103, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”	04.02.2015
4.	VKM nr. 386, datë 06.05.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Ujërave”	06.05.2015
5.	VKM nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”	13.05.2015
6.	VKM nr. 893, datë 04.11.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”	04.11.2015
7.	VKM nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”	04.11.2015
8.	Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. (Inspektimi i kalon pushtetit vendor)	21.12.2015

ANEKSI III: Draft akte nënligjore për miratim

Nr.	Baza ligjore (ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”)	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e pritshme e miratimit
1.	pika 3, neni 21	VKM për intervalet e testimit periodik rregullat e hollësishme për procedure e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë	Brenda vitit
2.	pika 3, neni 51	VKM për Organizimi i organit epror për çdo inspektorat shtetëror	Brenda vitit
3.	pika 7, neni 48	VKM për rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit	Brenda vitit
4.	pika 2, neni 26	VKM për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë	Brenda vitit
5.	pika 7, neni 38	VKM për procedurat për marrjen dhe trajtimin e mostrave sipas tipit të inspektimit si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve	Brenda vitit